

**Kuvendi i Republikës së Kosovës**

**Letra e Bardhë**

**SFIDAT E PËRFSHIRJES  
SOCIALE NË KOSOVË**



**Tetor 2009**

**Përbajtja:**

<b>Fjala hyrëse e kryeparlamentarit Krasniqi.....</b>	<b>3</b>
<b>Sfidat e Përfsirjes Sociale në Kosovë, Letra e Bardhë.....</b>	<b>6</b>
<b>Kapitulli I.....</b>	<b>8</b>
Qëndrimet e Kuvendit.....	8
Koncepti.....	10
Grupet e përjashtuara.....	11
Shkaqet e përjashtimit.....	12
<b>Kapitulli II - Qasja në të mira publike dhe në jetën e komunitetit.....</b>	<b>15</b>
Jeta politike.....	15
Informimi.....	15
Mediat.....	16
Regjistrimi civil.....	17
Administrata publike.....	18
Drejtësia.....	19
Jeta kulturore dhe shoqëria civile.....	20
Shëndetsia.....	21
Asistenca sociale.....	23
Punësimi.....	24
Arsimimi.....	26
Financat.....	28
Mjedisi ekonomik.....	30
Shërbimet publike.....	32
<b>Kapitulli III - Grupet e Përjashtuara.....</b>	<b>35</b>
Grupet në rrezik më të lartë nga përjashtimit.....	35
Personat me aftësi të kufizuara .....	35
Femrat.....	36
Fëmijët.....	36
Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas.....	36
Personat e zhvendosur brenda vendit.....	37
Personat me çrrregullime të stresit post-traumatik.....	39
Ekonomitë e mëdha familjare.....	39
Refugjatët dhe të kthyerit.....	40
Diaspora.....	40
<b>Kapitulli IV - Dimensionet shtesë të përjashtimit.....</b>	<b>41</b>
Dimensioni rajonal.....	41
Dimensioni Mjedor.....	43
Aneksi.....	43

## Fjala hyrëse e kryeparlamentarit Krasniqi në publikimin “Sfidat e Përfshirjes Sociale në Kosovë”

### Agjenda e përfshirjes sociale në Kosovë zhvillohet në një kontekst të ri historik dhe politik

Në mesin e sfidave të ndryshme me të cilat përballet Kosova aktualisht, sfida e përfshirjes sociale është nga më të ndjeshmet.

Përfshirja sociale, qoftë si politikë e veçantë qoftë si proces gjithëpërfshirës, synon zgjerimin e spektrit të mundësive të qytetarëve në lidhje me punësim, mirëqenie, arsim, komunikim, pjesëmarrje apo argëtim.

Përfshirja sociale do të thotë qytetari më aktive dhe pjesëmarrëse në vendimmarje, shoqëri më të informuar, do të thotë refuzim i prirjeve dominuese apo diskriminuese, të cilësdo formë dhe në cilindo nivel brenda shoqërisë. Përfshirja sociale nënkupton përkrahjen e atyre që ndodhen në vështirësi, si dhe afirmimin e njerëzve të cilët vuajnë si pasojë e ndonjë kufizimi natyror apo shoqëror.

Në vende dhe shoqëri të ndryshme, varësisht nga vështirësitë me të cilat përballen, përfshirja sociale trajton të moshuarit, fëmijët, personat më aftësi të kufizuara, të pastrehët, qytetarët që kërkojnë ndonjë punë dhe informacion, qytetarët pa arsimim elementar, qytetarët e mënjanuar nga vendimmarja dhe nga jeta shoqërore e politike. Kësisoj, ata nuk mund ose nuk janë në gjendje të ushtrojnë më shumë ndikim në lidhje me fatin dhe meritat e tyre në shoqëri, apo nuk mund të refuzojnë një padrejtësi, pavarësisht se ligji ua garanton këtë.

Përfshirja sociale implikon nevojën për ndërmarrjen e politikave, ligjeve, masave të drejta dhe të balancuara, në sfera të ndryshme për të mirën e qytetarëve pa asnjë dallim. Përfshirja sociale ndërvepron për së afërmi edhe me Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës me Rezolutën e 17 titorit, 2008. Objektivat synojnë zhdukjen e varfërisë së skajshme dhe të urisë, arritjen e arsimimit fillor për të gjithë, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e rolit të femrave në shoqëri, reduktimin e vdekshmërisë së foshnjave dhe nënave gjatë lindjes, luftimin e sëmundjeve ngjitése, sigurimin e qëndrueshmërisë së mjedisit dhe partneritetin global.

Duke konsideruar situatën e vështirë të qytetarëve të kategorive të ndryshme sociale, përfshirja sociale, gjithashtu do të thotë sforcim financier dhe

afatizim i veprimeve, të cilat duhet ndërmarrë me ndjenjë urgjence dhe me kujdes analistik. Këto veprime duhet ndërmarrë nën dritën e transparencës për qytetarët që përfaqësojmë.

Përfshirja sociale tejkalon vijat ndarëse dhe siguron partneritet demokratik e përparimtar, për të krijuar vlerën sociale dhe politike që kontribuon drejt një jete më të mirë për secilin pa përjashtim. Përfshirja sociale ndikon në energji të shtuara, mobilizim të tyre, ndikon në afrimin mes nesh, në të mirë apo në vështirësi.

Në Kosovë, lista e përjashtimit social është e gjatë dhe e dhembshme, në radhë të parë si pasojë e një historie të padrejtë shfrytëzimi dhe keqtrajtimi afatgjatë, por pa përjashtuar edhe aspektet e brendshme, karakteristikë e përbashkët për të gjitha shoqërítë në zhvillim në Evropë, sikurse janë kujdesi në lidhje me shëndetin, ambientin, apo përkushtimi për solidaritet më të madh ndërqytetar.

Në shoqërinë tonë ka kategori të tëra qytetarësh të dëmtuar rëndë në të kaluarën, si ish të burgosurit politikë, robërit dhe invalidët e luftës, femrat e keqtrajtuara dhe të dhunuara gjatë luftës, të zhvendosurit e luftës, fëmijët e traumatizuar dhe jetimë. Kjo gjendje e vështirë për këta qytetarë dhe për shoqërinë tonë në përgjithësi, i bën më të vështira por jo të pamundura përpjekjet e institucioneve tona për ngushtimin dhe më pastaj flakjen e listës së përjashtimit.

Duke reflektuar në lidhje me këtë situatë, si dhe duke dashur të përcjellë trendët e përparimit për një përfshirje më të madhe sociale, sipas shembujve të mirë që po zhvillohen brenda Bashkimit Evropian dhe në rajon, Kuvendi i Kosovës e ka hartuar këtë dokument të emërtuar “Sfidat e Përfshirjes Sociale në Kosovë”, në mënyrë që identifikimi i të prekurve nga përjashtimi social, t'u shërbejë institucioneve në planet e tyre të veprimit.

“Sfidat e Përfshirjes Sociale në Kosovë” është hartuar me përkrahjen e Agjencioneve të Kombeve të Bashkuara dhe në frymën e aspiratës evropiane të Kosovës. Dokumenti trajton aspekte të gjithanshme të përjashtimit social, sipas konceptit evropian dhe kushteve konkrete të Kosovës.

Ajenda e përfshirjes sociale në Kosovë zhvillohet në një kontekst të ri historik dhe politik, në të cilin fryma kushtetuese dhe përkushtimi integrues evropian na shërbejnë jo vetëm si inspirim për ndërmarrjen dhe zbatimin e politikave dhe legislacionit të përparuar, por edhe si nxitje për të ndryshuar

pozitivisht gjendjen e të përjashtuarve në shoqërinë tonë. Është kjo fryma me të cilën synojmë të vazhdojmë ndërtimin e shtetit tonë të ri dhe të institucioneve demokratike.

Institucionet e Kosovës janë angazhuar në proces që po e ndërlidh zhvillimin ekonomik me drejtësinë sociale dhe përparimin e gjithëmbarshëm social, politik e kulturor. Ky përparim do t'i përfshijë të gjithë dhe pa asnje dallim.



## Sfidat e Përfshirjes Sociale në Kosovë, Letra e Bardhë

### Hyrje

Nxjerra e Letrës së Bardhë për Sfidat e Përfshirjes Sociale Kosovare (SPSK), e përgatitur nga Kuvendi i Kosovës (KiK), paraqet dhe nënkuption një zotim të institucioneve të Kosovës te vlerat demokratike, një përfshirje më të madhe sociale dhe një të ardhme të begatshme për të gjithë. Kjo nismë i ka shërbyer Kuvendit të Kosovës që ta ushtrojë rolin e tij në përfaqësim, duke shërbyer si një zë përmë të prekurit. Si institucion, Kuvendi i Kosovës, ka shfaqur një angazhim të madh përmë vendosjen e popullit të Kosovës, në radhë të parë duke e bërë të qartë vizionin përmë ambiciet e tij përmë Integrimit Evropian.

Letra e Bardhë është një deklaratë e zotimit politik të Kuvendit të Kosovës, me anë të së cilës paraqiten çështjet e përjashtimit social dhe kontribuohet në nxitjen e diskutimeve dhe të debateve rreth tyre. Dokumenti ka si fokus të tij të varfrit, të rinjtë, të moshuarit, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Komunitetin e romëve, të ashkalinjve dhe të egjiptianëve, të zhvendosurit brenda vendit, refugjatët dhe individët ose grupet e tjera të përjashtuara në marrëdhëni shoqërore. Dokumenti paraqet një paralajmërim përmë gjendjen e këtyre grupeve të veçanta, që shpesh gjenden në skaje të shoqërisë kosovare. Ai paraqet konceptin e agjendës së përfshirjes sociale dhe i nënëvizon zotimet e Kuvendit të Kosovës drejt arritjes së Qëllimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (DZhM) dhe radhitjen e tyre në agjendën e Përfshirjes Evropiane.

Anëtarët e veçuar të Parlamentit (AP), femra dhe meshkuj, nga mqedise të ndryshme, spektre politike dhe ekspertiza, kanë shfaqur dedikim të qartë, vullnet personal dhe politik në procesin e hartimit të Letrës së Bardhë. Në shqyrtimin e çështjeve, që kanë të bëjnë me më të prekurit, AP-it i kanë shtruar këto çështje në elektoratin e tyre dhe kanë krijuar partneritete me shoqërinë civile në ndalimin e çështjeve të tilla. Puna dhe entuziazmi i tyre janë përmë lavdatë.

Kjo nismë është një hap i rëndësishëm që mori Kuvendi i Kosovës. Ajo tregon një moment historik përmë vizionin e Kosovës përmë zhvillimin e

avancuar të njeriut. Lëshimi i SPSK- së është vetëm fillimi i procesit, që do të vazhdojë të zgjerohet. Kjo do të ketë implikime të larta politike dhe strategjike, por edhe do t'u drejtohet rezultateve pozitive për më të prekurit.

Ekipi Kosovar i Kombeve të Bashkuara e përkrahu Kuvendin e Kosovës që ta paraqesë SPSK-në dhe është zotuar ta vazhdojë partneritetin e tij me institucionet të cilave u adresohen çështje të identifikuara në Letrën e Bardhë dhe t'i mbështesë arritjen e QZhM-së dhe shtrirjen më të gjerë sociale në nivelet lokale, rjonale dhe globale. Duke i shfaqur të njëjtat angazhime globale, vizioni i zhdukjes së varfërisë, shtrirja më e gjerë dhe forcimi i pozitës së grupeve të prekura, siç janë gratë, rinia, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet joshumicë, gjendja mund të përmirësohet.

Hap tjetër në këtë proces të partneritetit është shënjuar duke ndërmarrë një vështrim në përfshirjen sociale me 6.000 të anketuar, për ta finalizuar deri në fund të këtij viti. Vështrimi do të ndihmojë të theksohen me maturi çështjet e përcaktuara në SPSK dhe të mbështet kërkimi i mëtutjeshëm për përgatitjen e implikimeve politike dhe strategjike për çështjet e përfshirjes sociale. Diskutimet dhe politikat do të vazhdojnë në të mirë të më të prekurve në shoqërinë kosovare.

## Kapitulli I

### Sfidat e Përfshirjes Sociale

#### Hyrje

Letra e bardhë<sup>1</sup> e Kuvendit të Kosovës ka për qëllim të prezantojë konceptin e përfshirjes sociale dhe të theksojë fushat e përjashtimit të individëve dhe grupeve dhe të cenuar brenda shoqërisë Kosovare. Qëllim tjetër i këtij dokumentit është intensifikimi i angazhimit të Kuvendit të Kosovës në një diskutim më të gjerë rreth çështjeve të cilat i kontribuojnë zhvillimit të një shoqërie më përfshirëse, më kohezive, dhe mirëqenies më të madhe sociale. Letra e bardhë është dokument i parë i këtij lloji, dhe është rezultat i angazhimit të Kuvendit të Kosovës në avancimin e përfshirjes sociale dhe të zhvillimit njerëzor, duke forcuar kështu përkushtimin e drejtpërdrejtë të dhënë me aprovimin e Rezolutës së Deklaratës së Mijëvjeçarit. Letra e bardhë synon të identifikojë çështjet që prekin individët dhe grupet e cenuara në shoqërinë Kosovare. Dokumenti nuk propozon politika, strategji apo rekomandime që duhet të ndërmerren nga ana e qeverisë së Kosovës por fokusohet kryesisht në paralajmërimin e situatës e cila prek individët dhe grupeve të përjashtuara, si dhe shtron kërkesën për adresimin e drejtë të çështjeve të tyre.

Konstatimet nga Letra e bardhë synojnë të ndikojnë në nxitjen e një diskutimi më të gjerë institucional e publik të mbështetur në agjendën evropiane për përfshirje sociale, dhe t'i kontribuojnë politikë-bërjes më të informuar në lidhje me këtë aspekt. Dokumenti synon që nëpërmjet hapjes dhe forcimit të diskutimit të shpiej tek procese specifike institucionale që do të avancojnë agjendën e përfshirjes sociale në Kosovë.

Përfundimisht, Letra e bardhë ka për qëllim të kontribuoj në aspiratat e Kosovës për një shoqëri gjithëpërfshirëse me mundësi më të shumta për të gjithë. Duke shpresuar që përfshirja sociale si proces të fuqizojë kapacitetet e Kosovës për integrim Evropian, Kuvendi i Kosovës është veçanërisht i interesuar për të përvetsuar praktikat më të mira të përfshirjes sociale nga rajoni dhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE).

#### Qëndrimet e Kuvendit

Për Kuvendin e Kosovës, adresimi i menjëhershëm i nevojave të individëve

<sup>1</sup> Letra e bardhë është një dokument apo raport, zakonisht i lëshuar nga institucionet shtetërore, që prezanton apo adreson koncepte, politika, sfida, ose probleme të cilat ndihmojnë në informim dhe edukim më të gjerë për politik-bërje. Letra e bardhë nuk ka karakter obligativ dhe si e tillë është konsultative. Lëshimi i letrave të bardha është bërë traditiv në shumë parlamente dhe qeveri të shteteve Evropiane.

dhe grupeve të përjashtuar është me rëndësi kritike për forcimin e përfshirjës sociale në Kosovë.

Përfshirja më e madhe sociale ndërlidhet ngushtë me përvetësimin e objektivave që dalin nga Strategjia e Lisbonës së BE-së. Kjo strategji ka për qëllim të krijojë ndërveprim pozitiv midis konkurrencës së shtuar në fushën ekonomike dhe të punësimit, me nevojën për përfshirje sociale, si dhe përmirësim të mirëqenës për individët dhe grupet e cenuara brenda shoqërisë evropiane. Në këtë kontekst, Kuvendi i Kosovës përmes Rezolutës së Deklaratës së Mijëvjeçarit, të aprovuar më 17 tetor 2008, si dhe Rezolutës për Prioritetet dhe Strategjitet e Kosovës për Integrin në Bashkimin Evropian të aprovuar më 26 shkurt 2009, është zotuar që do të adresoj sfidat e ndryshme të proceseve integruese<sup>2</sup>. Angazhimi më i madh në rritjen e përfshirjes sociale dhe zhvillimit njerëzor, vetëm sa fuqizon përpjekjet e Kosovës në rrugën e saj drejt integrimit në Bashkimin Evropian.

Adresimi i këtyre sfidave është gjithashtu i rëndësishëm për të shtyer Kosovën në rrugën drejt arritjes së Kritereve të Laeken-it<sup>3</sup> dhe Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit<sup>4</sup> (OZHM). Megjithatë, Kuvendi është në dijeni të faktit se procesi i përfshirjes sociale kërkon përpjekje afatgjate, përpjekje të cilat kërkojnë mekanizma më të mirë të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave, dhe zotime të reja financiare.

*Ne, Populli i Kosovës,*

*Të vendosur për të ndërtuar një ardhmëri të Kosovës si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës, i cili do të jetë atdhe i të gjithë qytetarëve të vet;*

*Të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e sicilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit;*

*Të zotuar që Kosova të jetë shtet i mirëqenies ekonomike dhe i propseritetit social;*

...

### ***Preambula e Kushtetutës së Republikës së Kosovës***

<sup>2</sup> Rezoluta e Deklaratës së Mijëvjeçarit dhe për Prioritetet dhe Strategjitet e Kosovës për Integrin në Bashkimin Evropian gjenden në Aneksin e dokumentit

<sup>3</sup> Indikatorët e Laeken-it gjinden në Aneksin e dokumentit

<sup>4</sup> 8 Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit gjinden në Aneksin e dokumentit

Përfshirja sociale ka rëndësi të veçantë për Kosovën, për shkak të historisë së hidhur të saj, e sidomos për shkak të padrejtësive dhe shkatërrimeve me të cilat është përballur gjatë viteve 1990-ta. Për pasojë, shumica dërrmuese e popullsisë së Kosovës, është thellësish e prekur nga përjashtimi nga shumë të drejta, të lidhura me një apo më shumë dimensione të përjashtimit social apo individual. Në këto rrethana, a para se të kërkohen zgjidhjet politike, përpjekjet institucionale duhet të përqëndrohen në dy aspektet e mbështetësore. Së pari, të identifikohen gjerësish se se cilët janë individët dhe grupet e përjashtuara në Kosovë, dhe së dyti, cilat janë shkaqet më të ndjeshme që ndikojnë në përjashtim.

## Koncepti

Përfshirja sociale është një koncept që synon të krijojë, ruaj dhe të forcojë proceset ku individët dhe grupet, pavarësisht dallimeve mes tyre, mund të çojnë një jetë më të mirë. Është pranuar se kjo mund të arrihet vetëm atëherë kur njerëzit mund të shfrytëzojnë potencialin e tyre dhe përfitojnë nga mundësitat sociale në dispozicion. Kësisoj, përfshirja sociale nënkupton një proces i cili mundëson që të gjithë individëve dhe grupeve t’iu krijohen mundësi që të luajnë një rol të plotë në të gjitha aspektet e jetës sociale. Për të qenë të përfshirë, atyre duhet të ju krijohen apo ofrohen mundësitat e:

- Edukimit sipas nevojës dhe interesimit të tyre;
- Punësimit të përcjellë me siguri sociale;
- Qasjes më të lehta në shërbime publike dhe komunitare;
- Lidhjes me familje, shokë, punë, interesa personale dhe komunitet lokal; dhe
- Që zëri i tyre të dëgjohet.

Në këtë linjë, Kuvendi i Kosovës e huazon përkufizimin e përfshirjes sociale të BE-së, si një “proces i cili siguron që ata që janë në rrezik nga varfëria dhe përjashtimi social të përfitojnë mundësitë dhe burimet e nevojshme për të marrë pjesë plotësisht në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore, të gjëzojnë një standard të jetesës dhe të mirëqenies që konsiderohet si standard normal për shoqërinë në të cilën ata jetojnë. Ky koncept siguron që ata të kenë pjesmarrje më të lartë në vendim-marrje me ndikim në jetën e tyre si dhe të kenë qasje në të drejtat e tyre themelore.” Përballë kësaj aspirate dalin sfida të shumta të cilat kërkojnë të zgjidhen në nivel qendror, lokal apo edhe me të ulët.

Ajgenda e përfshirjes sociale synon që t'i kundërvihet përjashtimit social, duke provuar që të adresojë shpërbërjen sociale, e cila i shkëput individët dhe grupet nga marrëdhëniet sociale dhe institucionet, duke pamundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë në aktivitetet e shoqërisë në të cilën ata jetojnë. Kjo shkëputje dhe përjashtim janë rrjedhoje e:

-Qasjes së penguar në rrjete formale dhe jo formale, duke qenë së barrierat për pjesëmarrje më domethënëse në jetën sociale dhe institucionale ekzistojnë.

-Mungesës së integrimit ndërmjet individëve dhe grupeve si rezultat i dallimeve gjuhësore, mundësive më të pakta për edukim, barrierave gjeografike apo paragjykimeve sociale kundrejt këtyre grupeve dhe qytarëve.

-Deprivimit material, i cili është kryesisht rezultat i varfërisë dhe ceneshmërisë ekonomike të individëve dhe grupeve të cilët nuk mund të përballojnë qasjen në informacion, rrjete sociale, si dhe procese vendimmarrëse, apo për shkak se nuk kanë të ardhura të mjaftueshme financiare

Këta faktor së bashku apo veç e veç ndikojnë në qasjen jo adekuate në procese sociale dhe institucionale, në të drejta apo mundësi. Përveç tjerash, kjo rezulton në shfaqjen e pengesave në ofrimin e kujdesit të duhur shëndetësor, edukimin cilësor, punësim, shërbime sociale, në sigurim social, strehim, ndihmë ligjore, por edhe për shërbime komerciale sikurse bankat apo sigurimet.

## Grupet e përjashtuara

**Përjashtimi social** është një proces ku individë dhe grupe, duke qenë të cenuar nga varfëria, mos përgatitja e duhur arsimore, mungesa e shkathtësive profesionale, fizike apo intelektuale, janë të shtyer të jetojnë në marginat e shoqërisë.

Kjo i lagon ata nga mundësitë për punë, të ardhura dhe edukim, sikurse që i lagon edhe nga përfitimet nga komunikimi dhe rrjetëzimi social. Për më keq, gjendja e disfavorshme sociale në të cilën gjenden, i kufizon ata që të

ndikojnë apo të kenë më shumë zë kundrejt zhvillimit të proceseve të vendimmarjës apo politikave nga të cilat preken duke patur më pak gjasa të ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së tyre.

Në këtë kontekst, një numër i madh i qytetarëve në Kosovë bëjnë pjesë së paku në një kategori të të qenurit të përjashtuar. Individët dhe grupet e përjashtuara janë të personat me aftesi të kufizuara, të varférat, fëmijët, të rintjtë, të moshuarit, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas, të zhvendosurit brenda vendit (PZHBV), refugiatët dhe të kthyerit, diaspora, familjet që kanë antarë fati i të cilëve nuk dihet si të zhdukur nga konflikti, veteranët dhe invalidët e luftës, të burgosurit politikë, pësonat me çrregullime të stresit post-traumatik, gratë viktima të dhunës familjare, gratë e abuzuara gjatë luftës, të pastrehët, homoseksualët, të varurit nga narkotiket dhe të infektuarit nga HIV/AIDS. Në këtë kuptim, iniciativat e ardhshme të përfshirjes sociale duhet të synojnë përfshirjen e individëve dhe grupeve që bien në njëren nga këto kategori të përjashtuarve.

### **Shkaqet e përjashtimit**

Është vështirë të bëjmë dallimin në mes të shkaqeve dhe pasojave që dalin nga përjashtimi social. Mirëpo, *varfëria* ka të bëjë me të dyja. Deprivimi nga mundësitetë materiale për të ekzistuar mund të jetë shkaktar i marginalizimit të individëve dhe grupeve, e poashtu, përjashtimi nga mundësitetë për edukim dhe pjesëmarrje të mirëfilltë në shoqëri mund të çojnë drejtë varfërisë. Diskutimet me ekspert relevantë në Kosovë kanë rezultuar në identifikimin e shkaktarëve të përfshirjes sociale të shënuar si më poshtë.

Varfëria është njëri ndër shkaktarët më dominant që ndikon në përjashtimin social. Varfëria në Kosovë ka mbetur e pandryshuar që nga konflikti me përafersisht 45% të njerezve të varfér dhe 15% në varféri të skajshme<sup>5</sup>. Në këto rrethana, fëmijët dhe të rintjtë, femrat dhe pleqtë përballen me vështirësi shtesë, dhe janë në rrezik më të madh nga varfëria se sa grupet tjera. Qytetarët që i përkasin njërs nga këto kategori, ose kanë shkallë të lartë të papunësisë ose kanë të ardhura më të ulëta, dhe nuk kanë mënyra tjera ekonomike për të përfituar të ardhura.

Vecanërisht, nënët e vetme dhe gratë e moshuara kanë të ardhura më të ulëta, prandaj përballen me cenueshmëri më të madhe nga varfëria. Me këtë

<sup>5</sup> Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë 2008 , Banka Botrore, Enti Statistikor i Kosovës, [http://www.ks-gov.net/ESK/index.php?option=com\\_content&view=article&id=104&Itemid=92](http://www.ks-gov.net/ESK/index.php?option=com_content&view=article&id=104&Itemid=92)

lidhet edhe rreziku i varfërisë së fëmijëve. Gjithashtu, përjashtimi social në shumicën e vendeve ka korrelacion të ngushtë me **moshën**.

Ekonomitë familjare me më shumë se tre fëmijë, duket të ketë të ngjarë që të janë më të varfër sesa familjet me më pak se tre fëmijë. Prandaj edhe fëmijët që jetojnë në këto familje, ka më shumë të ngjarë të janë më të varfër sesa popullsia e përgjithshme.

**Papunësia** është një shkakar tjetër i përjashtimit social, veçanërisht papunësia afatgjate. Rreziku nga varfëria rritet me ngritjen e papunësisë. Kjo shpesh ndodh në kombinim me faktorë tjerë, siç janë kualifikimi i ulët arsimor, mosha dhe përkatësia gjinore e kulturore. Është e njohur se **papunësia e femrave dhe të rinjve** (15-24 vjet) është e lartë, dhe duke marrë parasysh krizën globale të kohëve të fundit, ky grup është gjithnjë e më shumë në rrezik nga varfëria<sup>6</sup>.

**Faktorët etnik dhe kulturor** gjithashtu ndikojnë dukshëm në raport me varfërinë dhe përjashtimin social. Disa grupe të komuniteteve jo shumicë, siç janë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptias, si dhe PZHBV-të përballen

me rrezik më të lartë nga varfëria. Duke u përballur me papunësi të nivelit të lartë, nivel të ulët të arsimimit, apo mungesë të parakushteve formale pë realizimin e plotë të të drejtave, pjesëtarët e këtyre komuniteteve i takojnë grupeve të cenuara. Në këtë kontekst, dallimet gjuhësore shqipërisë si bariera në komunikimin ndër-qytetar duke penguar përfshirjen më të madhe sociale. Gjithashtu, shfrytëzimi jo adekuat i sistemit të drejtësisë dhe qasjes së kufizuar në informacion, ndikojnë negativisht në përfshirje.

### Shkaqet e Përjashtimit Social

Varfëria

Papunësia afat-gjatë

Mungesa e qasjes në shërbime publike

Faktorët etnik dhe kulturor

Niveli i ulët i edukimit

Mungesa e regjistrimit civil

Mungesa e infrastrukturës

Zhvendosja e brendshme

Dimensioni regional

Gjinia

Mosha

<sup>6</sup> Statistikat e Tregut të Punës, Enti Statistikor i Kosovës, [http://www.ks-gov.net/ESK/index.php?option=com\\_docman&task=doc\\_view&gid=531&tmpl=component&format=raw&Itemid=8](http://www.ks-gov.net/ESK/index.php?option=com_docman&task=doc_view&gid=531&tmpl=component&format=raw&Itemid=8)

Në përjashtimin social ndikojnë edhe barrierat **gjeografike**. Në disa raste reziku nga varfëria është më i lartë në rajone ose komuna të veçanta, të cilat nuk janë të lidhura mirë me infrastrukturën rrugore, ndërsa në raste të tjera është i përqendruar në zonat e veçanta urbane që janë pjesët më të varfëra brenda qyteteve më të mëdha, si dhe të cilat nuk kanë infrastrukturë dhe qasje në shërbime publike.

Një aspekt i veçantë dhe specifik për realitetin Kosovar i cili ndikon në përjashtim është se që nga viti 1981 nuk ka pasur regjistrim të plotë civil. Si rezultat i mungesës së të dhënave ekzakte edhe në këtë dokument përdoren vlerësimet në bazë të të cilave në Kosovë jetojnë rreth 2.1 milion banorë. Këto vlerësimë vijnë nga burime të ndryshme, siç është Enti Statistikor i Kosovës, Banka Botërore dhe Agjencitë tjetra të Kombeve të Bashkuara, etj.

## Kapitulli II

### Qasja në të mirat publike dhe në jetën e komunitetit

Përfshirja sociale paraqet një koncept të gjerë, prandaj vende të ndryshme kanë përqafuar qasje të ndryshme në lidhje me zbatimin dhe arritjet praktike që lidhen me këtë koncept. Vendet anëtare të BE-së, kolektivisht kanë miratuar strategjitet që synojnë të realizojnë objektiva që lidhen me përfshirjen më të madhe sociale. Në mënyrë të ngjashme, ky koncept është bërë shumë i rëndësishëm dhe i nevojshëm për vendet që aspirojnë për t'u integruar në BE.

Kosova ka mundësi të kufizuara për të realizuar qëllimet e synuara për përfshirje më të madhe sociale në nivel që bëjnë vendet anëtare të Bashkimit Evropian, por është duke bërë dhe do të shtojë përpjekjet e sajës në këtë drejtim.

#### Jeta politike

Ekzistojnë pengesa të ndryshme të cilat prekin individë dhe grupe në shoqërinë Kosovare, duke i kufizuar ata në gjëzimin e realizimit të mundësive përmes qasjes më të madhe në jetën politike. Në mesin e tyre, janë femrat, të rinjtë, dhe të moshuarit.

Sistemi i kuotave të përfaqësimit të femrave në Kuvend është vetëm një mekanizëm i veçuar i cili synon që të përmirësoj qasjen më të madhe të femrave, apo grupeve tjera në jetën politike. Femrat dhe të rinjtë kanë vështirësi në qasje dhe ndikim më të madh në vendim-marrje politike dhe institucionale<sup>7</sup>. Në një pozitë të ngjashme, gjenden edhe gupe tjera, sidomos qytetarët e prekur nga varfëria, të cilët nuk kanë qasje apo mundësi të marrin pjese aktive në jetën politike, apo në informacion. Duke u nisur nga kjo gjendje dhe mungesa e një forme sistematike në fuqizimin e këtyre individëve dhe grupeve sociale, ekziston rreziku real i përjashtimit dhe mos përfaqësimit të tyre.

#### Informimi

Qasja në informata zyrtare është siguruar me ligjin për qasje në dokumente zyrtare. Provat tregojnë se zbatimi i këtij ligji është solid. Një sfidë specifike shfaqet te kërkesa për informacione mbi zhvillimet institucionale nga opinioni i gjerë publik. Përveç kësaj, ekziston një mungesë e madhe e

<sup>7</sup> Femrat dhe të rinjtë nuk janë të përfaqësuar në shkallë të duhur në pozita vendim-marrës në institucionet e Kosovës. Një konkludim i tillë ka dal nga takimet me zyrtarë komunal dhe shoqërinë civile nëpër Komuna – Gjilan dhe Mitrovicë, nëntor 2008

vetëdijesimit publik për të gjuar të drejtën e dhënë në këtë ligj. Kjo vjen nga fakti se ka shumë pak kërkesa për qasje në dokumente zyrtare<sup>8</sup>. Qasja në informata në lidhje me të drejtat themelore, shërbimet shëndetësore dhe sociale dhe mundësitë e arsimimit, ende është në pikëpyetje për shkak të arsyeve të mëposhtme:

- Qasja e kufizuar në informacione për shkak të shtrirjes së kufizuar dhe të duhur të teknologjisë informative;
- Mos-disponueshmëria e informatës në të tri gjuhët zyrtare nëpër disa komuna;
- Mungesa e metodave pro-aktive nga ana e institucioneve për të arritur te grupet e shënjestruara;
- Analafabetizmi i disa grupeve, në veçanti në mesin e femrave dhe të komuniteteve rom, ashkali dhe egiptas;
- Mungesa e mjedisit të qasshëm për pësonat me aftësi të kufizuara.

Qasja në informata është një parakusht për përfshirjen në rrjedhat e jetës së shoqërisë.

## Media

Legjislacioni i Kosovës garanton të drejtën për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim, për të marrë dhe dhënë informacion në gjuhën e tyre përmes mediave. Për më shumë, legjislacioni i siguron të drejtën të gjitha komuniteteve për të krijuar media në gjuhën e tyre, dhe të drejtën për përfaqësim të posaçëm në mediat publike. Legjislacioni përbush standardet më të larta në mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe lirinë e medias.

Tetë gazetat e përditshme kanë tirazh të vlerësuar ditor së bashku me jo më shumë se 25000-30000 kopje.

Monitori i Helsinkit, 2007

Aktualisht në Kosovë shpwrndahen tetë gazeta ditore në gjuhën shqipe, tri në gjuhën serbe si dhe njw në atë turke. Kosova ka një nga normat më të ulta të tirazhit të gazetave në Evropë<sup>9</sup>.

Nga 114 transmetues të licencuar në Kosovë, 44 transmetojnë në gjuhët jo-shumicë (34 në gjuhën serbe, katër në gjuhën boshnjake, tre në turqisht, dy

<sup>8</sup> Raporti Implementimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare në Nivelin Komunal, OSCE, nëntor 2007 [http://www.osce.org/documents/mik/2007/11/27791\\_sq.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2007/11/27791_sq.pdf)

<sup>9</sup> Monitori i Helsinkit: Siguria dhe të Drejtat Njerëzore, 2007, nr. 2 <http://www.uio.no/studier/emner/hf/imk/JOUR4330/h07/Zweeden%20The%20state%20of%20media%20in%20Kosovo.pdf>

në gjuhën gorane dhe një stacion në gjuhën rome). Dy stacione transmetojnë në mënyrë të barabartë në gjuhën shqipe dhe serbe. Në Kosovë funksionojnë tri platforma televizive – tokësore, satelitore dhe kablloviqe.

Pavarësisht, individë apo grupe sociale përballen me mungesë të theksuar në qasje dhe përfaqësim në mediat publike, sikurse edhe në programe më cilësore për të gjithë pa dallim<sup>10</sup>. Programet që synojnë audiencën jo shumicë në kuadër të Radio Televizionin e Kosovës (RTK) ende përbëjnë më pak se sa 15% të transmetimit, një nivel i cili kërkohet me ligj. Në anën tjetër, transmetimi i kanalit publik RTK nuk arrin të mbulojë 11% të territorit të Kosovës, përkatesisht zonat e Dragashit dhe të Hanit të Elezit. Me qëllim të përmirësimit të situatës së përgjithshme, një fond i themeluar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit synon që të shpërndajë grante për mediat e komuniteteve jo shumicë<sup>11</sup>. Deri më tani, burimet e duhura financiare nuk janë shpërndarë për këtë qëllim.

Ekzistojnë pengesa tjera që parandalojnë realizimin e qasjes më të mirë për të gjithë. Individë dhe grupe që jetojnë në viset e largëta përballen me më shumë vështirësi në qasjen në mediat elektronike, për shkak të mungesës së qëndrueshmërisë financiare. Gjithashtu ekziston një mungesë e qasjes në informata për shkak të privimit material, financiar dhe mundësive të kufizuara për posedime teknologjike nga qytetarët.

Komunitetet lokale dhe grupet e cuneshara nuk kanë qasje në media për të shprehur opinionin dhe problemet e tyre, qytetarët që jetojnë nën kufizime të energjisë elektrike, ata që u mungojnë pajisje për informacion dhe të teknologjisë, përfshirë këtu një numër të madh të ekonomive familjare të cilët për shkak të vështirësive financiare, arsimore dhe të infrastrukturës nuk mund të përfitojnë nga qasja në informatat në media apo në internet.

## Regjistrimi civil

Krijimi i një regjistri civil gjithëpërfshirës, të integruar dhe të efektshëm në tërë Kosovën është një ndër sfidat drejt përfshirjes sociale në Kosovë. Regjistrimi civil, si një e drejtë themelore, u jep atyre statusin e nënshtetësishë dhe të drejtat që rrjedhin duke qenë shtetas. Regjistrimi civil është parakusht për pjesëmarrje në shoqëri. Në të kundërtën, mungesa e regjistrimit, nuk u lejon të gjithë qytetarëve që në mënyrë adekuate të

<sup>10</sup> Nga takimi me zyrtarë komunal dhe shoqëri civile në Komunën e Mitrovicës, nëntor 2008

<sup>11</sup> Gjendja e Lirisë së Mediave, Observime dhe Rekomandime, OSCE, 2006

[http://www.osce.org/documents/rfm/2006/07/19767\\_en.pdf](http://www.osce.org/documents/rfm/2006/07/19767_en.pdf)

gëzojnë të drejtat e tyre themelore duke përfshirë edhe të drejtën për votim. Anembanë Kosovës ka njerëz të cilëve ende iu mungon regjistrimi i lindjes. Individë dhe grupe të cenuara në këtë drejtim, ndër të tjerë janë personat e zhvendosur, ata që jetojnë në diasporë, fëmijët, qytetarët që i përkasin komuniteteve jo shumicë, si dhe pësonat me aftësi të kufizuarat<sup>12</sup>.

Në rrithana të tilla, të gjithë qytetarët, pa dallim, që përballen me vështirësi për të fituar qasje në regjistrimin civil, përballen automatikisht edhe me përjashtimin ngajeta sociale dhe zhvillimet institucionale. Fakti se ata janë jo-ekzistues për sistemin ligjor e bën përfshirjen e tyre edhe më të ndërlidhur.

## Administrata publike

Përfshirja më e madhe e individëve dhe grupeve të cenuara nga komunitetetet jo shumicë ende nuk është arritur plotësisht. Në të dy nivelet,

atë lokal dhe qendror të administratës publike, femrat, personat me aftësi të kufizuarat dëshironin qytetarët e komuniteteve jo shumicë mbeten nën nivelin e duhur të përfaqësimit. Në pozitat e vendimarrjes këto grupe janë në një situatë edhe më pak të favorshme.

- 19,89% e posteve udhëheqëse në nivel qendror mbahen prej femrave
- Ne nivel komunal jane gjithësej femrat, 7.83%
- Në të gjitha postet udheh[se brenda administratës publike, femrat mbajnë 14,36%

• Minoritetet në administratën publike janë të përfaqsuara me rrith 12%. Raporti mbi Gjendjen e Administratës Publike në Kosovë, MPS 2007

publike 2006 - 2011 adreson nevojën për krijimin e infrastrukturës institucionale të nevojshme për të sjellë efikasitet më të madh të shërbimit të administratës publike. Qeveria i ka zotuar 6 milion euro për zbatimin e këtij plani të veprimit për vitin 2007-2009. Kjo Strategji ka në fokus përfshirjen e

Një pjesë e mirë e efikasitetit të shërbimeve të administratës publike ngritet dhe forcohet duke rritur përfshirjen më të madhe sociale. Strategjia dhe plani i veprimit i qeverisë për reformën e administratës

<sup>12</sup> Zyra për Institucionë Demokratike dhe të Drejtat e Njëreut, OSCE  
[http://www.osce.org/odihr/item\\_2\\_19838.html](http://www.osce.org/odihr/item_2_19838.html)

individëve dhe grupeve të cenuara.

Tash për tash qytetarët e komuniteteve jo shumicë përbëjnë 11.5% të nepunësve civilë në nivel qendror dhe 12% në nivelin lokal. Synohet që përfaqësimi i tyre të ngritet edhe më tej në vitet e ardhshme. Përfshirja më e madhe e qytetarëve nga komunitetet jo shumicë në institucionet e Kosovës është një zotim dhe proces i vazhdueshëm.

Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet përfshirjes së individëve dhe grupeve të cenuara si femrat, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara. Një shteg për zhvillim të shpejtë të karrierës së të rinjve në administratën publike do të motivojë sidomos personat e arsimuar mirë ose të diplomuar jashtë vendit që të kthehen, qëndrojnë dhe të punojnë për vendin.

### Drejtësia

Korniza ligjore e anti-diskriminimit në Kosovë përbëhet nga pjesë të rëndësishme të direktivave të komunitetit të BE-së. Megjithatë, zbatimi i masave anti-diskriminuese mbeten i dobët dhe i pamjaftueshëm.

Gjykimi i brendshëm i kimeve të luftës është udhëhequr vetëm nga gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë. Disa gjykime janë në vazhdim e sipër dhe shumë raste janë nën hetim. Ka disa qindra raste të pazgjidhura. Përafërsisht 240 raste të tjera të personave të zhdukur u zgjidhën, kurse 1940 persona mbeten të pagjetur<sup>13</sup>.

Kjo përbënë një situatë të përjashtimit. Në një shoqëri të dalë nga konflikti, kërkimi i drejtësisë si rezultat i gjykimeve të brendshme të kimeve të luftës mund të jetë një motivim i fuqishëm për të jetuar, për t'u bërë përsëri aktiv në jetën sociale dhe në rindërtimin e vendit, për të gjithë ata qytetarë të cilët janë prekur nga këto kime.

“Në fillim të tetorit [2008], numri i total i rasteve civile ende të pazgjidhura nëpër gjykata komunale Kosovë qëndron në 160,477. Nuk ka sistem veprimi për ekzekutimin e të gjitha vlerësimeve në gjykata. Më tej, me shumë se 36000 lëndë të kimeve janë ende të pazgjidhura nëpër gjykata.”

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian  
2008

<sup>13</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, nëntor 2008  
[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press\\_corner/key-documents/reports\\_nov\\_2008/kosovo\\_progress\\_report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/key-documents/reports_nov_2008/kosovo_progress_report_en.pdf)

Zhgënji i pakënaqësia nga mungesa e drejtësisë nga procesi gjykimeve dhe konstatimi rasteve të personave të pagjetur, mund të çojë një numër qytetarësh në marginizim dhe vet-përjashtim nga jetë sociale dhe nga shoqëria. Për më tepër, kjo mund të shpie në krijimin e një grupi të ri të cenesëshëm që mund të kenë nevojë të veçantë përfshirje.

Mijëra raste të pazgjidhura apo në pritje mbeten në gjykata, gjë që e bën joefikas sistemin gjyqësor të Kosovës, duke ndikuar negativisht në përfshirjen më të madhe sociale.

Në anën tjetër, sistemi ligjor i Kosovës ka nevojë përfshirje vendosur procedura të veçanta përfshirje miturit në konflikt me ligjin dhe përfshirje futur koncepte dhe institucionale të reja që kanë përfshirje reformimin e sistemit të drejtësisë penale përfshirje siguruar përgjithjen e saj me standartet ndërkombëtare dhe evropiane përfshirje drejtat të njeriut. Fëmijët duhet të trajtohen me humanizëm, dhe sistemi i drejtësisë duhet të ketë qasje të përqendruar tek fëmijët - qasje të specializuar dhe multi-disiplinare.

Funksionimi joefikas i sistemit të drejtësisë në Kosovë ngjallë pakënaqësi sociale dhe ndonjëherë krijon një mjeshtëri përfshirje ligjore.

### Jeta kulturore dhe shoqëria civile

Dialogu ndërkulturore (muzikë, teatër, art, religjion, debate publike) mbetet i dobët. Aktivitetet ndërkulturore në mes të komuniteteve kanë ndodhur kryesisht në nivel të OJQ-ve, të cilat kanë përfshirje që të ngrenë ura mbi hendekun që ndanë komunitetet mes vete, por një gje e tillë ka ndodhur vetëm deri në një masë të kufizuar.

Pavarësisht, ka pothuajse një mungesë të plotë të dialogut ndërkulturore dhe pothuajse secili qytetar i Kosovës është i prekur nga ky zhvillim.

Është një vlerësim i përafërt se ekzistojnë rreth 500 OJQ aktive të cilat punojnë në sfera të ndryshme sociale, ekonomike dhe politike.

Çdo i gjashti Kosovar është i inkadruar në një apo tjeterin nivel në organizatë të shoqërisë civile — 10 përqind si antarë, 5 përqind si vullnetarë dhe rreth 2 përqind të punësuar.

Raporti i Zhvillimit Njerëzor përfshirje Shoqëri Civile, 2009

Organizatat e shoqërisë civile në vend përbëhen kryesisht nga organizata të vogla të cilat shpesh janë të varura nga financimet me afat të shkurtër nga një donator i vetëm, sidomos ato në nivel komunal. Organizatat e shoqërisë civile janë kryesisht monoetnike, ndërsa gjithashtu në mes vete, këto organizata zhvillojnë një nivel të pamjaftueshëm të bashkëpunimit. Ekziston nevoja për fuqizimin e rrjeteve midis OJQ-ve.

Bashkëpunimi në mes të sektorit të shoqërisë civile me sektorin publik dhe atë të biznesit nuk është i kënaqshëm. Për më shumë mungon një strategji e qeverisë për zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile, veçanërisht në fushën e financimit publik për OJQ-të ose krijimin e lehtësirave tatinore për bizneset që financojnë veprimtaritë dhe projektet e zbatuara nga OJQ-të. Bashkëpunimi midis institucioneve dhe shoqërisë civile është thelbësor në avancimin e agjendës për përfshirjen sociale.

Kapacitetet administrative, financiare dhe menaxhuese të organizatave të shoqërisë civile janë shumë të pabarabarta, dhe janë veçanërisht të dobëta në nivelin komunal. Është me rëndësi jetike të ndërtohen dhe forcohen kapacitetet e OJQ-ve lokale, respektivisht aftësitë e tyre për avokim, rrjetëzim, dhe lobim në mënyrë që të mbështesin zhvillimin rajonal të Kosovës. Numri i vogël i OJQ-ve të cilat dallojnë? në kapacitete, ka nevojë të rritet për ta ranguar këtë sektor të shoqërisë, si një agjent ndryshimi dhe zhvillimi në shoqërinë kosovare.

## Shëndetësia

Gjendja e shërbimeve shëndetësore në Kosovë është ndikuar negativisht nga shumë faktorë: faktori historik i cili karakterizohet me dështime të sistemit të tipit socialist i cili iu nënshtrua dështimeve dhe diktateve politike që rezultuan me pengesa në qasje dhe përfshirje adekuate për popullatën shumicë; shkatërrimet dhe dëmtimet e periudhës së luftës të viteve 1997-1999. Pas vitit 1999 ndodhë një rehabilitim i gjërë dhe reformim i thellë i sistemit që përcillet me mungesë të kapaciteteve për rimëkëmbje dhe reformim efikas.

Ndonëse qasja fizike në kujdes shëndetësor është shumë e lartë, qasja në shërbime shëndetësore mbetet e kufizuar dhe ky sektor meriton vëmendje më të madhe. Sistemi shëndetësor i Kosovës ka ngecur në zhvillim dhe i

mungon financimi i mjaftueshëm dhe i qëndrueshëm. Investimet për shëndetësi paraqesin vetëm 3% të BPV-së që është shumë nën mesataren rajonale.

Treguesit e shëndetit dhe të ushqyerit në Kosovë janë larg nga vendet fqinje dhe ato të BE-së. Jetëgjatësia në lindje, që është 69 vjet për meshkuj dhe 71

vjet për femra, është nën mesataren e rajonit. 20 nga 1000 të sapolindur vdesin për rreth lindjes, ndërsa 35 prej 1000 foshnjave nuk arrijnë ditëlindjen e tyre të parë. Një e treta e fëmijëve nën moshën pesë vjeçare vuan nga mungesa e vitaminës A, dhe një në çdo

dhjetë fëmijë vuan nga keq-ushqimi kronik. Shkalla e vdekshmërisë amnore është 28 në 100 000, që është mbi treguesit korrespondues në Ballkanin Perëndimor<sup>14</sup>. Gjendja e shëndetit mendor të fëmijëve, grave/ nënave dhe njerëzve që vuajnë nga stresi post-traumatik nuk adresohet në mënyre adekuate.

Në parim, të gjithë qytetarët e Kosovës kanë qasje në kujdesin shëndetësor edhe pse në praktikë ky nuk është rasti. Por, ka raste ku individë dhe grupe kanë qasje të kufizuar në shërbime shëndetësore thelbësore siç është imunizimi<sup>15</sup>. Kostoja e shërbimeve shëndetësore dhe kostoja e barnave që duhen blerë paraqiten si barrierë për qasjen në kujdesin shëndetësor. Financimi i dobët publik në shëndetësi bartë shpenzimet tek pacientët dhe shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore, duke ndikuar drejtpërdrejt në varfëri. Shpenzimet më të larta që i bëjnë qytetarët nga gjepi i tyre për shëndetësi janë shpenzimet për barna si ato esenciale poashtu edhe ato që kërkohen gjatë trajimit spitalor, shpenzimet për diagnostikë si dhe joformale që i bëhen personelit në mënyrë që të sigurohen shërbimet shëndetësore.

Incidenca e lartë e pagesave joformale shpesh i atribuohet, së paku pjesërisht, pagave të ulëta të stafit të kujdesit shëndetësor. Komunitetet jo shumicë shpesh kanë vështirësi shtesë në qasjen në shërbimeve shëndetësore, sikurse qytetarët që jetojnë në varfëri, femrat, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, veteranët dhe PZHBV-të.

<sup>14</sup> Raporti Gjendja perinatale ne Kosovë per vitet 2000-2008, Ministria e Shëndetësisë, Maj 2009

<sup>15</sup> Raporti Qeverisja për fëmijë, UNICEF 2008

Nevojitet angazhimi i mëtejshëm dhe i vazhdueshëm për të siguruar integrimin e sistemit shëndetësor dhe dekurajimin e sistemeve paralele në mënyrë që të shtohet qasja dhe përfshirja për të gjithë banorët e Kosovës.

## Asistenca sociale

Qytetarët shpesh nuk janë të informuar në mënyrë adekuate për të drejtat të tyre, për mundësitet e qasjes në asistencën sociale dhe në shërbimet sociale që ofrohen. Kjo është kryesisht për shkak të organizimit institucional, i cili shihet si kompleks dhe jo sa duhet miqësor për shfrytëzuesit. Ekzistojnë sfida të mëdha në zhvillimin e ofrimit të shërbimeve sociale të lidhura me decentralizimin gradual të kompetencave nga institucionet qëndrore tek komunat. Komunat nuk kanë kapacitete dhe fonde të mjaftueshme për të ofruar shërbime sociale cilësore<sup>16</sup>. Përveç kësaj, ekziston një mungesë e stafit të kualifikuar në të dy nivelet, atë lokal dhe qendror.<sup>17</sup>

Ekzistojnë disa skema të asistencës finananciare në Kosovë: skema e asistencës sociale, skema pensionale për persona me nevoja të veçanta, për invalidët e luftës dhe të afërmit e tyre, skemat e pensioneve për të moshuarato bazë dhe për kontribuesit, pensionet për invalidët, dhe skema e pensionit për punëtorët e Trepçës. Përmes këtyre skemave të ndihmës sociale mbulohen mbi 300.000 persona, ose 15% e popullatës së Kosovës e cila shihet në nevojë për asistencë sociale<sup>18</sup>. Por nuk ka skema të asistencës sociale për kategori të veçanta që shihen si të përjashtuara, siç janë gratë e abuzuara gjatë konfliktit dhe për të ish-burgosurit politik të dekadave të kaluara.

Ekzistojnë kritere solide të sistemit të mirëqenjes sociale të bazuara në ligj, por shpesh ato nuk zbatohen në mënyrë të mjaftueshme dhe iu mungon mbështetja në treguesit e matshëm që dalin nga jeta reale<sup>19</sup>. Për programet e asistencës sociale një problem mbetet edhe përmirësimi i shënjestrimit të qytetarëve dhe grupeve në nevojë. Programet e asistencës sociale janë modeste në kuptim sasior. Kjo është e kuptueshme duke pasur parasysh kapacitetet materiale dhe kërkesat fiskale të vendit. Ekzistojnë tri dobësi të identifikuara të skemave të asistencës sociale. Së pari, programet kanë mbulesë të ulët në kuptim sasior, dhe kjo është pjesërisht për shkak të hapësirës së ngushtë fiskale. Së dyti, vlera e përfitimeve për ekonomitë familjare nën asistencë sociale nuk është indeksuar dhe rivalorizuar për të

<sup>16</sup> Udhërrëfyesi për Qeverisje të Qëndrueshme, 2008

<sup>17</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, nëntor 2008

<sup>18</sup> Dokumenti strategjik i hartimit të politikave sociale 2009-2015, Ministria e punës dhe mirëqenies sociale

<sup>20</sup> Nga takimi me zyrtarë komunal dhe shoqëri civile në Komunën e Mitrovicës dhe Gjilanit, nëntor 2008

pasqyruar ndryshimet ekonomike në vend, në radhë të parë inflacionin e indeksit të çmimeve, duke mbetur e sheshtë dhe duke ngecur në vlerë reale vit pas viti. Së treti, si pasojë e një mbulesë të ulët, shënjestrimit të dobët, dhe përfitimit mjaftë të ulët, ndikimi i asistencës sociale në përmirësimin më të theksuar të mirëqenjes dhe zbutjen e varfërisë çmohet si i pamjaftueshëm

Sistemi i pensioneve është finansiarisht i paqëndrueshëm, pasi që shkalla e papunësisë është e lartë dhe punësimi joformal ende vazhdon të jetë i zakonshëm. Sistemi aktual i sigurimit pensional paraqitet si vulnerabil në ndikimet e krizes globale financiare. Po ashtu nuk ka asnje kornizë ligjore që do të lidhte sistemin aktual me sistemin e pensioneve të ish Jugosllavisë, në të cilën popullata e Kosovës ka kontribuar me dekada.

## Punësimi

Shkalla e papunësisë në Kosovë, që konsiderohet të jetë rreth 45%, është më e larta në Ballkanin Perëndimor. Sipas anketës së fuqisë punëtore, gati gjysma e fuqisë aktive punëtore është e papunë. Kjo shkallë për individë dhe grupe të përjashtuara është dukshëm më e lartë se mesatarja e vendit. Shkalla e papunësisë përfmarrës dhe të rinjtë është në trendin rritës. Shkalla e papunësisë tek femrat është mbi 55% dhe përf 17% më e lartë se tek meshkujt. Papunësia e të rinjve (mes 15-24 vjeçar) është veçanërisht e lartë<sup>20</sup>. Në strukturën moshere të të papunëve 64% i takojnë grup-moshës 20-24 vjeçare. Çdo vit rreth 30.000 të rinj hyjnë në radhët e punë-kërkuesve përderisa më së shumti 15.000 vende të reja të punës velen në dispozicion gjatë një viti. I tërë ky grup është vënë gjithnjë e më shumë në rrezik të varfërisë. Megjithatë, ekzistojnë të dhëna që sygjerojnë se një numër i madh i personave të regjistruar si të papunë mund të jenë aktivë në ekonominë joformale.

## Niveli i papunësisë

	Totali	Meshkuj	Femra	Nën moshën 25 vjeç	Afat-gjatë
<b>Papunësia</b>	43.6 %	38.5%	55.2%	70%	37.1%

Raporti i Progresit të Komisionit Evropian 2008

Kosova nuk ka strategji gjithëpërfshirëse përfpunësimi në të cilën do të bazoheshin politika dhe plane më specifike në arritjen e qëllimeve që synojnë punësimin më të madh. Oferta përfpunësimi mbetet e ulët ndërsa

<sup>20</sup> Raporti i Zhvillimit Njerëzor, UNDP 2006

cilësitë dhe shkathësitë e fuqisë aktive punëtore jo gjithmonë korrespondojnë me nevojat që shtron kjo ofertë. Gjendja e tanishme e Kosovës ndërlikon mundësitë ligjore për të finalizuar marrëveshjet ndërkombtare për punë sezonale.

Rreziku nga varfëria është shumëfish më i lartë për të papunësuarit. Pavarësisht prej kësaj, jo të gjithë të papunët jetojnë në ekonomi familjare të varfëra, dhe jo të gjithë të punësuarit janë jo të varfër. Me fjalë të tjera, përderisa të varfërit e punësuar në kuptim sasior përbëjnë grupin më të madh midis të gjithë të varfërvë, shkalla e rrezikut për të qenë të varfër, është më e madhe për të papunët. Kushtet mbizotëruese të tregut të dobët të punës, shpjegojnë atë që dyshohet të jetë trend në rritje në pjesën e punësimit joformal. Në anën tjetër, për të papunësuarit, kohëzgjatjet e papunësisë janë të gjata. Ndërsa për të punësuarit pagat reale kanë mbetur pothuajse të pandryshuar në vitet e fundit.

Në rastin e Kosovës, sektorët vendimtar ku gjenerimi i punësimit mund të pritet të jetë i lartë përfshijnë transportin dhe infrastrukturën e komunikimit, ndërtimin, shërbimet, dhe bujqësinë. Theks të veçantë duhet t'i vëhet përmirësimit të klimës së investimeve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, posaçërisht duke vënë në dispozicion energjinë elektrike të përballueshme dhe me furnizim të besueshëm.

Administrata publike nuk arrin që në vazhdimësi të sigurojë zbatimin përkatës të legjisacionit ekzistues të punës. Duke pasur parasysh përmasat relativisht të mëdha të ekonomisë joformale, një numër i madh i të punësuarve nuk janë as të vetëdijshëm as në pozitë për të realizuar të drejtat e tyre në punë. Sindikatat mbeten të dobëta dhe të drejtat e punës në përgjithësi nuk respektohen<sup>21</sup>. Ligji i punës, i cili mund të përmirësonë gjendjen e punëtorëve, ende nuk është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Sektori privat, i cili përbën zemrën e çdo strategjie afat-gjate të qëndrueshme për zvogëlimin e papunësisë, është vazhdimisht në rritje, por kërkohet një mjeshtës më i mirë për zhvillimin e mëtejshëm të tij.

<sup>21</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, 2008



## Arsimimi

Raporti për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit 2006 për Kosovën bën thirrje për shkallën alarmante të ulët të regjistrimit para-shkollor. Vetëm një në dhjetë fëmijë të vegjël ndjekin aktivitetet parashkollore, aktivitete të cilat ndikojnë dukshëm në zhvillimin e fëmijëve dhe arritjet e mëvonshme në mësimin e rregullt. Situata me edukimin parashkollor është veçanërisht e vështirë në viset rurale duke i lënë ata fëmijë prapa që në fillim të formësimit të tyre të përgjithëshem.

Ekziston besimi i përhapur se cilësia e shkollimit në përgjithësi është e dobët. Si pasojë, rezultatet e mësimit për shumë fëmijë janë shpesh aq të ulëta sa që ata e braktisin shkollen. Shkollat, veçanërisht ato në zonat urbane, vazhdojnë të punojnë në katër ndërrime për shkak të mungesës së hapësirës adekuate. Gjendja fizike e infrastrukturës shkollore mbetet e dobët, ashtu që shkollat kanë mungesë të ndërtesave të përshtatshme, hapësirave përcjellëse për mësim e rekreacion, materialit didaktik dhe të paisjeve.

Qasja e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe aftësi të kufizuara është edhe më e komplikuar për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate, mungesës së materialeve mësimore dhe të mësuesve të specializuar<sup>22</sup>. Nëntë nga dhjetë fëmijë me nevoja të veçanta nuk ndjekin shkollën. Pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, gjithashtu kanë mungesë të mësuesve, librave dhe materialeve të nevojshme që do t'ju mundësonin atyre mësimin në gjuhen e tyre amtare<sup>23</sup>. Shpesh, ata përballen edhe me probleme të qasjes në arsimin e lartë.

Me ndihmën e donatorëve, qeveria ka vazhduar të investojë, në trajnim dhe ri-kualifikim me fokus mbi të rinjtë, pjesëtarët e komunitetit jo shumicë, femrat dhe personat me aftësi të kufizuara.

Lidhja e arsimit me varfëri është e pamohueshme. Incidenca e varfërisë në familjet ku kryefamiljari është i pa arsimuar apo me nivel të ulët të arsimimit është disa herë më e lartë se në familjet që u d h ë h i q e n n g a kryefamiljari i arsimuar. Kjo ndodhë sepse të arsinuarit kanë shanse më të mira për punësim dhe paga më të larta.

**Edukimi** po ashtu luan rol të rëndësishëm në gjendjen e punësimit. Rreth 66.50% e atyre me edukim universitar janë të punësuar, ndërsa nga ata me edukim të mesëm, vetëm 50% janë të punësuar. Numri i të punësuarve të cilët nuk kanë edukim formal është vetem 14%.

Hulumtimi i përfshirjes sociale, 2009

Ndryshe nga objektivat e BE-së për mësim gjatë tërë jetës, situata në sektorin e arsimit të Kosovës mbetet me shumë probleme dhe me rezultate të pamjaftueshme. Buxheti për arsim nuk është i mjaftueshëm për t'u përballe me një numër të madh të të rinjve, me sistemin paralel të arsimit dhe cilësinë e dobët e mësimdhënies në tërë Kosovën.

Në krahasim me vendet e tjera të rajonit, Kosova mbetet mbrapa me përqindjen e qytetarëve që me sukses mbarojnë studimet universitare. Megjithatë, përqindja e regjistrimit të studentëve në universitete është në rritje në vitet e fundit duke konsideruar hapjen e një numri të madh të universiteteve private<sup>24</sup>.

Evidenca poashtu konfirmon se performanca e Kosovës në lidhje me vijimin e shkollimit fillor dhe të mesëm është e lartë. Regjistrimi në edukim primar është 95%, dhe rreth 3 në 4 fëmijë regjistrohen në arsimin e mesëm të

<sup>22</sup> Nga takimi me zyrtarë komunal dhe shoqëri civile në Komunën e Mitrovicës dhe Gjilanit, nëntor 2008

<sup>23</sup> Raporti i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit për Kosovën, UNDP 2006

<sup>24</sup> Hulumtimi i Përfshirjes Sociale, UNDP 2009

lartë. Megjithatë, këto rezultate fshehin pengesa potenciale në krijimin e një popullsie mirë të arsimuar. Numri i nxënësve që e braktisin shkollën vazhdon të jetë i lartë. Arsyet janë të ndryshme, por që kryesisht lidhen me kushtet materiale. Vlerësohet se 33% e nxënësve braktisin shkollën për arsyet ekonomike, të cilat lidhen direkt me varférinë, ndërsa 15% e tyre për shkak që është dashur të fillojnë punën dhe të gjenerojnë të ardhura për jetesë. Kjo është më e theksuar në zonat rurale.



## Financat

**Përjashtimi Bankar - transaksionet** - qasja në banka (shërbimet e transaksioneve bankare në veçanti) duket se është nevojë universale. Mungesa e qasjes ose shfrytëzimit të kësaj dispozite financiare ka efekte negative në të cilin përfshirja sociale mund të dëmtohet në mënyrë të vazhdueshme. Ndodh kështu sepse, qasja në shërbime bankare është qelës kryesor për qasjen në shërbime të tjera financiare (kredi/kursime). Mungesa e kësaj qasje pengon qasjen në treg dhe rezulton me mundësi jo të barabarta për përfshirje dhe zhvillim, prandaj si pasojë mund të rrissë prezikun e varférisë. Pasi që nuk është e mjaftueshme qasja në një llogari bankare për t'u kualifikuar si “financiarisht i përfshirë”, mund të merren parasysh këto

shkallë për adresim të përfshirjes më të madhe: 1) 'pa llogari bankare' të cilët në përgjithësi janë njerëz pa llogari bankare, 2) llogari bankare 'marginale' të cilët janë qytetarët me një llogari depozite dhe nuk kanë mundësinë e pagesës elektronike dhe nuk kanë kartelë pagesë ose çek. Gjithashtu mund të janë njerëz që kanë këto kapacitete por i përdorin pak ose fare, dhe 3) 'pako të plotë bankare' janë qytetarët që kanë qasje në një gamë të gjërë të shërbimeve të transaksioneve bankare që janë të përshtatshme për nevojat e tyre dhe për gjendjen socio-ekonomike.

**Përjashtimi nga kreditë** – Kredia është mjeti kryesor financiar për të lehtësuar qasjen në të mirat materiale ose për shpenzimet që tejkalojnë buxhetin mujor, siç janë pajisjet (p.sh. automjeti, strehimi, orenditë, garancitë për qira), si dhe për mundësimin e vetë-punësimit nëpërmes krijimit të biznesit vetanak. Përvojat e propozuara për skemat e mikro-kredive, me ofruesit pa përfitim, dëshmojnë për ndikimin pozitiv social, që një kredi e vogël dhe e përshtatshme mund t'i sjellë ekonomive familjare. Nëpërmes mundësimit më të favorshëm të këtij mjeti financiar, pra përfshirjes në mikro-kredi, do të krijoeshin parakushtet për: përmirësimin e lëvizshmërisë dhe komunikimit, përmirësimit të cilësisë së banimit, përmirësimit të gjendjes së punësimit në ekonomitë familjare, rritjen e mundësive për arsim.

Mungesa e qasjes ose shfrytëzimit të kësaj dispozite financiare mund të ketë ndikim negativ në përfshirjen sociale, në mënyra të ndryshme: 1) mungesa e qasjes në kredi të përshtatshme, pa mundëson qasjen në disa të mira materiale nëpërmes të cilave realizohet një standard minimal i jetesës, si dhe mund të stigmatizojë dhe të zvogëlojë nivelin e mirëqenies dhe vetëbesimit; 2 ) mungesa e qasjes në kredi të përshtatshme mund të çojë në mungesë të vetë-punësimit dhe mundësi të biznesit, mund të shtojë çekuilibrin e buxhetit të ekonomisë familjare për kohë të gjatë, dhe 3) mund të çojë në borxh të tepruar, ndërsa borxhi i tepruar mund të çojë në përjashtim financiar dhe social.

Kreditë bankare për sektorin privat në Kosovë janë shtuar, por norma e interesit ka mbetur shumë e lartë në 10.4% që është perceptuar si një pengesë për qasje në kredi<sup>25</sup>.

<sup>25</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, 2008

**Përjashtimi nga sigurimi** - Sot disa lloje të sigurimit janë të rëndësishme në organizimin e shoqërive moderne, dhe, disa prej tyre, janë të detyrueshme (për shembull, ato për përdorimin e automjeteve, ose për të kryer ndonjë punë). Megjithatë, nuk ka asnjë përkufizim të qartë se cilat lloje të sigurimeve konsiderohen thelbësore në mënyrë që kushdo që nuk i ka, do të mund të konsiderohet financiarisht i përjashtuar. Në rastet kur sigurimi është i detyrueshëm për qasje në disa shërbime, qasja e lehtë dhe shfrytëzimi duhet të konsiderohen si pjesë e një qëllimi për përfshirje. Për më tepër, mjetet e sigurimit për qëllime të pensionit janë në rritje, për shkak të vështirësive të njohura të sistemeve shtetërore të mirëqenies.



## Mjedisi ekonomik

Numri i bizneseve të regjistruar në Kosovë është në rritje. Ndërsa pasiguria rreth politikave irregullatore, kostos dhe qasjes në financime i krijon probleme bizneseve. Më shumë se 80% e investimeve të reja u financuan nga burimet vetanake. Arsyet kryesore të raportuara për mungesë të mbështetjes për huamarje zyrtare ishin normat shumë të larta të interesit. Edhe pse normat e reja të taksave kanë hyrë në fuqi që nga 1 janari 2009, 70% e bizneseve perceptuan normat e taksave si shumë të larta dhe çdo i dyti

biznes vlerëson rregulloret e punës si tepër kufizuese. Shfrytëzimi i gjykatave për të zgjidhur çështjet pronësore mbetet i pamjaftueshmë. Korrupsioni dhe pasiguria mbi të drejtat pronësore mbeten pengesë e madhe për veprimtarinë ekonomike, pjesërisht për shkak të kontesteve ligjore dhe pjesërisht për shkak të regjistrave të pasigurt të tokës ose humbja e kadastrës së biznesit. Në përgjithësi, mungesa e sundimit të ligjit po pengon zhvillimin e biznesit.

## Normat e interesit për biznese

Normat e Interesit për shumë për bankë	PCB	RBKO	BKT	BPB	NLB	BEK	TEB
€ 10,000	15.6%	14%	14%		14%	14%	-
€ 25,000	13.8%	14%	13.5%		14%	14%	-
€ 50,000	13.2%	13.5%	13%		14%	14%	-
€ 100,000	NEG	13.5%	12.5%		14%	14%	-

Instituti Gap, 2009

Infrastruktura e dobët e transportit dhe telekomunikacionit pengon zgjerimin e aktivitetit të sektorit privat. Shumë ndërrmarje të vogla dhe të mesme (NMV-të) vuajnë nga qasja e kufizuar në shërbime online (në internet). Mungesa e transportit, si dhe shërbimeve që lidhen me teknologjinë informative pengojnë qasjen e bizneseve të Kosovës në tregun e BE-së dhe kufizojnë përfitimet nga integrimi i tregtisë rajonale. Baza teknologjike e ekonomisë ka mbetur tejet e dobët. Struktura e ndërmarrjeve mbizotërohet nga mikro-ndërmarrjet. Gati gjysma e të gjitha bizneseve, janë biznese që merren me shitje-blerje me shumicë dhe pakicë, të përcjellë nga përpunimi i ushqimit, ndërtimi dhe shërbimet tjera sociale e personale. Ekonomia joformale mbetet e madhe, që ndikon në aftësinë konkurruese të ekonomisë. Bujqësia vazhdon të vuajë nga çështjet e pazgjidhura të drejtave pronësore dhe nivelet e dobëta të investimeve kapitale. Si pasojë, Kosova nuk ishte në gjendje që të shfrytëzojë potencialin e vet për zëvendësim të importit, më produkte vetanake që është në gjendje ti prodhojë. Kështu vendi ka ngecur në prodhimin e artikujve ushqimor të papërpunuar dhe të përpunuar. Ky mund të jetë një mekanizëm i fuqishëm tregtar por edhe i punësimit, i cili do të ndikonte në zvogëlimin e deficitit të jashtëm të saj tregtar por edhe gjenerimin e vendeve të punës.

Sektori bujqësor i Kosovës ka potencial të veçantë për zhvillim në zonat

rurale, ku jeton shumica e popullsisë (rreth 60%). Momentalisht ky sektor kontribuon me vetëm 30% në Bruto Produktin Vendor (BPV) për vit<sup>26</sup>. Kjo lidhje në mes të sektorit bujqësor, popullsisë në zonat rurale, dhe zhvillimit të ekonomisë është me rëndësi dhe duhet të jetë më e theksuar kur vendoset për shpenzimet qeveritare apo në përpjekjet e reformave në këtë sektor. Mungesa e pronësisë politike, e kombinuar me pengesa të rënda buxhetore, dhe mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare, ka penguar zbatimin e planit të qeverisë për zhvillim bujqësor dhe rural 2007-2013<sup>27</sup>.



## Shërbimet publike

**Strehimi dhe prona (përfshirë edhe tokën bujqësore)** në aspektin e përfshirjes sociale ngecin prapa. Ekzistojnë probleme të grumbulluara në lidhje me pronat: injorancë e përhapur kundrejt lejeve të ndërtimit dhe planifikimit urban, procesi i papërfunduar i pretendimeve pronësore pas konfliktit, si dhe procedurat e shpronësimit të ndërmarra nga komunat me qëllim të ndërtimit të infrastrukturës publike shpesh dështojnë në njoftim dhe kompensim të pronarit të pronës. Si rezultat, qasja në strehim cilësor mbetet një sfidë.

<sup>26</sup> Bruto Produkti Vendor (BPV) për kokë banori në Kosovë, sipas Entitit të Statistikës së Kosovës është rreth € 1612. Ndërsa me rajonin Kosova krahasohet në nivel të ulët. BPV e Kosovës është gati katër (4) herë më e vogël se ajo e Maqedonisë, Bosnies dhe Hercegovinës dhe Shqipërisë

[http://www.ks-gov.net/esk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=73&Itemid=59](http://www.ks-gov.net/esk/index.php?option=com_content&view=article&id=73&Itemid=59)

<sup>27</sup> Plani për Zhvillim Rural dhe Bujqësor 2007-2013 për Kosovën, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Përfshirja sociale lidhet ngushtë me mundësimin e realizimit të drejtë, të plotë dhe efikas të të drejtës së pronësisë. Aktualisht në Kosovë ekzistojnë sfida të shumta të cilat demtojnë realizimin e të drejtës së pronësisë nga të gjithë qytetarët gjithandej Kosovës dhe pa asnjë dallim. Kjo gjendje ka të bëjë me nevojën për përmirësimin e legjislacionit në këtë fushë si dhe infrastrukture e cila mundeson realizimin efikas të këtij legjislacioni. Jo të gjithë qytetarët kanë mundësi të jenë të sigurt nga keqpërdorimet e dokumentacionit të pronësisë, apo të kenë mundësi që të shfyrtezojnë shërbimet e një sistemi kadastral bashkohor dhe të regjistrimit të pronës së tyre.

Një aspekt tjetër me rëndesi është edhe shpronësimi në mënyrë adekuate sepse shpronsimi jo korrekt dhe arbitrar nga ana e institucioneve rezikon të drejtën e pronësisë si e drejte e patjetërsueshme në një shoqëri demokratike. Nga ana tjetër, përfshirja lidhet edhe me efikasitetin e zbatimit të ligjit për ndërtimë nga ana e qytetarëve, sepse ndërtimet ilegale vetëm sa dëmtojnë të drejtat e qytetarëve në shkallë të lartë. Hapat e parë të cilët do t'i adresoninte këto sfida janë përmirësimet në legjislacion, infrastrukturë si dhe ngritja në përgjegjësi kur është fjala të ushtrimi i funksioneve publike nga ana e zyrtarëve të angazhuar në këtë fushë<sup>28</sup>.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas janë ende shumë të papërfshira. Ende ekzistojnë shumë vendbanime joformale, që ofrojnë kushte të dëmshme të jetesës.

Kundërthëniet midis pjesëve të ndryshme të legjislacionit në këtë fushë dhe aktorëve të ndryshëm në krye të vendimmarries dhe të veprimeve, mund të çojnë në mungesë të qasjes në strehim dhe prona (duke përfshirë edhe tokën bujqësore) dhe respektivisht në përashtimin e disa grupeve siç janë personat e zhvendosur dhe komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptas.

Hapat e parë të cilët do të adresonin këto sfida janë përmirësimet në legjislacion, infrastrukturë si dhe ngritja në përgjegjësi kur është fjala te ushtrimi I funksioneve publike nga ana e zyrtarëve të angazhuar në këtë fushë.

**Furnizimi me energji elektrike** mbetet jo i besueshëm në Kosovë,

<sup>28</sup> Korruptioni në administrimin e pronës/menagjimin e pronës në Kosovë, Transparency International, 2008. <http://www.u4.no/helpdesk/helpdesk/query.cfm?id=175>

veçanërisht në viset e rurale dhe të largëta. Ndërprerjet e energjisë ende janë të shpeshta. Zbatimi i domosdoshëm i renovimit të paisjeve kryesore të miqes së lignitit, përgatitjet për hapjen me kohë të minierave të Sibovcit Jugperëndimor, si dhe përmirësimi i mbledhjes së pagesave dhe shkyçja e konsumatorëve të paligjshëm janë thelbësore për Kosovën.

Grumbullimi i fondeve për zbatimin e Programit të Kosovës për Efikasitetin e Energjisë dhe Burimet e Ripërtërishme mbetet një sfidë. Ka mungesë të zhvillimit të infrastrukturës së përshtatshme dhe të investimeve në rrjetin e shpërndarjes. Kjo ndikon negativisht në furnizimin me energji të zonave rurale dhe në veçanti ato të largëta.

Qasja e qëndrueshme dhe e rregullt në furnizimin me energji elektrike do të ofronte baza solide për zhvillim të rrjedhshëm në shumë fusha të jetës shoqërore, veçanërisht në mjedisin e biznesit.

Një pjesë e madhe e popullsisë raporton të jetë privuar në dimensione të shumëfishhta. Për shembull, disa janë materialisht të varfér dhe nuk kanë qasje në ujë të pijshëm brenda shtëpisë dhe instalime hidrosanitare të duhura. Vetëm 79.1% e amvisërive në Kosovë kanë qasje në ujë të pijshëm nga ujësjellësi<sup>29</sup>. Të tjerët nuk kanë qasje në lidhje telefonike ose nuk kanë banjë në shtëpi<sup>30</sup>. Shërbimet e komunitetit janë shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik.

<sup>29</sup> Hulumtimi i Përfshirjes Sociale, UNDP 2009

<sup>30</sup> Sipas Hulumtimit të Përfshirjes Sociale, UNDP 2009, rreth 40% të amvisërive kanë qasje në telefoni fiks, ndërsa 82% prej tyre posedojnë telefonë mobil

## Kapitulli III

### Grupet e përjashtuara

#### Grupet në rrezik më të lartë nga përjashtimi

Grupet e përjashtuara përballen me lloje të ndryshme të faktorëve kërcënues, përfshirë këtu varférinë dhe përjashtimin. Këto grupe disponojnë me resurse të ndryshme, por në përgjithësi të pamjaftueshme përtu përballur me këto kërcënimë. Cenueshmëria nuk ka të bëj me përkatësinë apo prejardhjen në ndonjë grupi; ajo është çështje e përballjes me disa rreziqe për qytetarët që janë të përjashtuar.

Përveç varférisë, njerëzit mund të gjejnë veten në pozita të përjashtimit duke filluar nga mungesa e regjistrimit të popullatës që nga viti 1981, mungesës së të dhënave statistikore të mjaftueshme, regjistrimit civil, pastaj edhe për shkak të mungesës së mundësive arsimore, sigurisë jo-përkatëse personale (fizike), strehimit të dobët, apo qasjes së dobët në kujdesin shëndetësor, paftësinë fizike, mentale, ose emocionale; moshën apo gjendjen familjare (p.sh. prindër të vetëm). Kështu mund të mblidhet dhe mund të aplikohet një listë e tërë e përcaktuesve të cenueshmërisë edhe për individët e veçantë edhe për grupet.

Midis grupeve që janë në rrezik të veçantë nga varférija dhe përjashtimi janë ekonomitë e mëdha familjare, femrat, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat me çrregullime të stresit post-traumatike, komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptas, personat e zhvendosurit brenda vendit, refugjatët dhe të kthyerit, dhe diaspora. Mungesa e edukimit si dhe papunësimi janë dy tema të përgjithshme që ndikojnë dukshëm të gjitha këto grupe.

#### Personat me aftësi të kufizuara

Personat me aftësi të kufizuara vuajnë nga përjashtime të shumta: qasja adekuate e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin cilësor, mungesa e qasjes në skemat e asistencës sociale për shkak të kritereve të papërshtatshme dhe mundësi më të vogla punësimi. Qasja në informacion dhe të drejtat sociale janë veçanërisht të vështira për pësonat me aftësi të kufizuara, kryesisht për shkak të mungesës së infrastrukturës publike të qasshme dhe shërbimeve sociale që i njofton ata<sup>31</sup>.

<sup>31</sup> Nga takimi me zyrtarë komunal dhe shoqëri civile në Komunat e Mitrovicë dhe Gjilan, nëntor 2008

## Femrat

Femrat vuajnë nga përjashtime të shumta. Ato kanë nivel më të ulët të arsimimit, më pak mundësi punësimi, ballafaqohen me martesa të hershme, si dhe në disa raste, me vlerat, traditat dhe stereotipet jo-favorizuese. Përkundër kuotave legjislativë në disa fusha ato ende përballen me diskriminimin gjinor, sidomos në qasje në pozitat vendimarrëse dhe në jetën ekonomike.

Në disa raste, femrat janë subjekt i dhunës familjare dhe trafikimit. Femrat janë shpesh subjekt i diskriminimit ekonomik dhe i mungesës së qasjes në të ardhura apo kapital. Vetëm 2% nga numri i përgjithshëm i kredive i është dhënë grave. Vetëdijesimi për drejtat e femrës në shoqëri është i ulët.

## Fëmijët

Jeta e fëmijëve në Kosovë karakterizohet nga trajtimi i dobët shëndetësor, mungesa e qasjes në edukimin parashkollor, cilësia e dobët e arsimimit, braktisja e hershme e shkollës kryesisht për shkak të nevojës për të punuar duke mbështetur familjet e tyre, si dhe nga martesat e hershme. Puna e fëmijëve mbetet një nga problemet kryesore, pasi që varfëria dhe përjashtimi janë tipare të përgjithshme të familjeve me shumë anëtarë dhe veçanërisht me shumë fëmijë dhe gra kryefamiljare. Varfëria tek fëmijët është më e lartë se tek popullata e përgjithshme. Fëmijët përbëjnë një të tretën e popullatës që jeton në varfëri të skajshme (16,7%)<sup>32</sup>.

Buxheti i ndarë për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve është i pamjaftueshëm për të arritur qëllimin. Shkalla e vdekshmërisë foshnjore në Kosovë mbetet e lartë<sup>33</sup>. Mekanizmat mbrojtës janë të papërshtatshëm për të mbrojtur fëmijët nga dhuna, trafikimi i fëmijëve dhe fëmijët punëtorë, për të rritur përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veqanta dhe fëmijët që i përkasin komuniteteve jo shumicë, veçanërisht në arsim. Edukimi parashkollor nuk është i detyrueshëm, dhe shpesh është i cilësisë së dobët. Ligjet për shërbimet sociale dhe familjare nuk zbatohen dhe në disa raste janë kontradiktore, veçanërisht në lidhje me adaptim dhe kujdesin e fëmijëve.

## Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas

Komunitetet e varfëra rom, ashkali dhe egjiptas janë në borxhe të tepërtë – faturat e tyre të papaguara të shërbimeve komunale tejkalojnë për mbi 12

<sup>32</sup> Varfëria e fëmijëve në Kosovë. UNICEF, Universiteti i York-ut, dhe Social Policy Research Unit, 2008.

<sup>33</sup> Raporti i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, UNDP 2006

herë shpenzimet e tyre mujore. Ekonomitë familjare kanë grumbulluar faturat e papaguara të energjisë elektrike, të furnizimit me ujë dhe strehimit. Vijimi në shkollë nga fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas është i ulët në të gjitha nivelet e arsimit. Qasja më e mirë në arsim cilësor shpesh shihet si një parakusht për rritjen e punësimit dhe për këtë arsyе edhe për potencialin e të ardhurave.

Femrat nga këto komunitete kanë më pak mundësi punësimi dhe qasje më të dobët në të ardhura dhe kapital sesa meshkujtë. Kjo iu pamundëson atyre tejkalimin e varfërisë dhe përmirësimin e jetës së tyre. Shkalla e papunësisë në parim është dukshëm më e lartë te komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas sesa te komunitetet shumicë. Punësimi i qytetarëve nga këto komunitete është përqendruar në tregti, bujqësi, ndërtim dhe sektorë të shërbimeve komunale. Mbizotëron punësimi me kualifikime të ulëta që është i lidhur me të ardhura të ulëta, cilësi të dobët të punës, dhe mbrojtje të dobët sociale dhe të punësimit. Vetë-punësimi është më pak i zakonshëm në mesin e tyre. ëë Qasja e kufizuar në financa bankare është një kufizim serioz. Huamarrësit me perspektivë shpesh pengohen nga mungesa e historisë së kredisë dhe mungesa e kolateralit (të cilat janë probleme kryesore për të varfrit në përgjithësi, jo vetëm për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas). Mosha është faktor më i vogël në papunësinë ëë tyre. Lokacioni është një përcaktues i rëndësishëm i papunësisë; stinët gjithashtu kanë rëndësi, pasi që romët, ashkalit dhe egjiptasit përfshihen në punë bujqësore në stinën e vjeshtës (korrije) dhe të pranverës (mbjellje).

Shëndeti dhe kushtet e të ushqyerit, perceptimet e ndryshme të kërcënimit dhe gjendja e strehimit janë aspekte të rëndësishme të ceneshmërisë. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas kanë mungesë të qasjes në shërbimet mjekësore, përfshirë edhe mjekësinë familjare, dhe shpesh nuk mund të përballojnë blerjen e barërave të përshkruara. Edhe mungesa e dokumenteve të duhura të identitetit dhe të shëndetësisë është një pengesë veçanërisht e theksuar për komunitetet në fjalë.

### **Personat e zhvendosur brenda vendit**

Personat e zhvendosur brenda vendit përbëjnë një grup me cënueshmëri të lartë duke qenë se këta persona përballen me rreziqe të larta dhe jo të zakonshme, me theks varfërinë dhe përjashtimin social. Familjet e

zhvendosura zakonisht përballen me mundësi të pakta të punësimit ose bariera për tiu qasur shërbimeve themelore. Në disa raste ato kanë mungesë të gjendjes civile të tyre (regjistrimi, letërnjoftimi, etj.)<sup>34</sup> Familjet e zhvendosura kanë tendencë për të rënë në varféri të thellë. Normat e varfërisë në mesin e personave të zhvendosur janë pothuajse dyfish më të larta në qyatete, ndërsa në zonat rurale duket se ata përfitojnë më shumë mbështetje nga rrjetet familjare dhe mënyra e jetesës.

Punëtorët e familjeve të zhvendosura janë të tej-përfaqësuar në sektorët e punës manuale me kualifikime të ulëta, dhe janë të nën-përfaqësuar në punësim në sektorin publik. Të zhvendosurit gjithashtu përballen me mundësitë e kufizuara për vetë-punësim dhe qasje në kredi prandaj kanë tendencë që të mbështeten në familje dhe burime tjera jozyrtare të huazimit. Të zhvendosurit gjithashtu kanë pak të ngjarë që të kenë tokë në pronësi e tyre. Një pjesë të madhe e ekonomive familjare të zhvendosura marrin hua për përmirësimë në shtëpi dhe kjo mund të shpjegojë ngurrimin e bankave për të dhënë hua.

Papunësia në mesin e të rinjve është pak më e lartë në mesin e familjeve të zhvendosura. Shkalla e papunësisë për femrat e familjeve të zhvendosura është shumë më e lartë sesa te meshkujt, dhe kjo shkallë është më e lartë pavarësisht përkatësisë së tyre etnike.

Të dhënat tregojnë se të zhvendosurit përballen me një situatë shumë të pasigurt strehimi. Shumica jetojnë në strehime kolektive për të zhvendosur dhe refugjatë me infrastrukturë të ujësjellsit dhe kanalizimeve nën standarde të kërkuara. Këto kushte, dhe fakti se ato vende shpesh janë shumë më prapa sesa vendet nga të cilat ata u larguan, do të thotë se të zhvendosurit posedojnë më pak gjëra themelore të ekonomisë familjare, siç janë orënditë ose librat.

Qasja në teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit është shpesh e kufizuar dhe joadekuate. Shkalla e gjendjes shëndetësore te personat e zhvendosur është më e ulët. Disa dallime të rëndësishme gjinore ekzistojnë në lidhje me incidentët e sëmundjeve kronike; femrat janë më të prekura nga sëmundjet kronike. Të zhvendosurit kanë më shumë gjasa që të vuajnë nga neuroza dhe çrrëgullimet që lidhen me traumat psikologjike nga

<sup>34</sup> Romët e zhvendosur dhe të drejtat pronësore, Jose-Maria Arraiza and Linda Öhman. Forced Migration Review. <http://www.finreview.org/FMRpdfs/FMR32/43-45.pdf>

zhvendosja. Distancat më të mëdha fizike të objekteve shëndetësore, të ardhurat e ulëta, dhe mungesa e dokumenteve të duhura të identitetit, janë pengesa të mëdha për qasjen në shërbimet shëndetësore për ekonomitë familjare të zhvendosura. Mbulesa e pamjaftueshme me vaksinim (shumë shpesh për shkak të dokumenteve jo të duhura të identitetit, mungesës së kartelave të imunizimit) është një përcaktues i rëndësishëm i cenueshmërisë, veçanërisht për fëmijët e zhvendosur.

Fëmijët e familjeve të zhvendosura janë veçanërisht të cenueshëm ndaj rreziqeve arsimore për shkak të distancës së shkollës ose pengesave gjuhësore. Sëmundjet kronike, mungesa e veshjes së duhur, si dhe mos-toleranca nga fëmijët lokal mund të shtojë më tej vështirësitë. Edhe kur fëmijët tregojnë interesim në shkollë, qëndrimet kulturore në arsim komplikojnë barrierat psikologjike dhe praktike për vijim në shkollë. Disa prej fëmijëve janë në jetimore, të tjerët janë në kujdes familjar, të tjerët jetojnë me kushërinjtë e afërm ose të largët. Rreziqet nga keq-ushqimi gjithashtu janë të pranishme, ku deri më sot, shujtat në shkollë nuk kanë qenë pjesë të programeve të arsimit. Ndërkohë që këto rreziqe janë të pranishme për gjithë popullsinë, ato mund të janë veçanërisht të vështira për fëmijët e zhvendosur.

### **Personat me çrrëgullime të stresit post-traumatik**

Nuk është e qartë se deri në çfarë mase janë identifikuar pësonat që vuajnë nga stresi post-traumatik. Konflikti ka prekur njerëzit psikologjikisht dhe mentalisht. Shqetësimet e atyre që kanë nevojë më të madhe janë adresuar në një mënyrë apo në një tjetër. Por konsiderohet se është një grup i njerëzve që vuau nga nivelet e ndryshme të stresit të fshehur post-traumatik që reflektohet nëpërmjet shumë formave të depresionit. Në shumë raste kjo nuk është e njohur ose pranuar.

### **Ekonomitë e mëdha familjare**

Profilizimi i varfërisë në Kosovë tregon se incidenca e varfërisë te ekonomitë familjare me më shumë se 7 anëtarë është më e lartë se sa te ekonomitë familjare me 1 deri në 3 anëtarë<sup>35</sup>. Përveç madhësisë së familjes, përbërja e familjes paraqet barrë shtesë në përmirësimin e mirëqenies. Ekonomitë familjare me më shumë anëtarë të varur (fëmijë, pleq, persona me aftësi të kufizuar etj), sesa anëtarë të rritur të punësuar kanë incidencë më

<sup>35</sup> Vlerësimi i Varfërisë 2007, Banka Botërore

të lartë të varfërisë krahasuar me ekonomitë familjare me më shumë të rritur sesa të persona varur. Ekonomitë familjare me gratë si kryefamiljare, ekonomitë familjare me shumë fëmijë dhe të moshuar janë në rrezik të veçantë nga përjashtimi.

### **Refugjatet dhe të kthyerit**

Numri i refugjatëve të cilët pritet të kthehen në shtëpitë e tyre në Kosovë është i lartë. Kushtet e vështira socio-ekonomike dhe standardi i ultë i jetesës, të karakterizuar me shkallën e lartë të papunësisë si dhe me skema të ulëta të asistencës sociale, vështirëson që të sigurohet një re-integrim i lehtë dhe i qëndrueshëm i atyre që kthehen në Kosovë. Mungesa e mundësive të punësimit në Kosovë si dhe shkëputja afatgjate nga tregu i punës mund të jetë mbingarkese përkushtet e tyre.

### **Diaspora**

Numri i qytetarëve të Kosovës të cilët jetojnë jashtë llogaritet të jetë më se gjysëm milioni. Ata të cilët e kanë të pazgjidhur statusin e tyre të strehimit përballen me vështirësi që të posedojnë dokumentacionet e Kosovës. Ata hasin në vështirësi për të realizuar të drejtat e tyre për posedim të dokumentacionit personal për shkak të pamundësisë që të jenë fizikisht të pranishëm në zyrat të cilat lëshojnë këto dokumente.

10 për qind e popullatës jeton në familje shumë-antarëshe me më 8-9 persona, dhe 12 përqind me 10 apo me shumë persona.

UNDP Mozaik Kosova, 2006

Mungesa e metodave proaktive për të arritur tek votuesit jashtë Kosovës si dhe mungesa e informacionit nuk i ka dhënë kësaj pjese të popullatës mundësinë që të marrin pjesë në votim.

## Kapitulli IV

### Dimensionet shtesë të përjashtimit

#### Dimensioni rajonal

Koncepti i përfshirjes sociale karakterizohet dukshem edhe nga dimensioni rajonal. Në aspektin rajonal përfshirja sociale si koncept implikoni zhvillimin e politikave të përfshirjes në një zonë gjeografike që kërkon përshtatje të veçantë me kontekstin e zonës. Nga kjo rrjedh si rezultat i asaj që (1) politikat në nivel kombëtar mund të janë joadekuate ose më pak efektive sesa zgjidhjet e përshtatura brenda rajonit ose lokalitetit mirë të definuar; dhe (2) sfidat e përfshirjes që duhet të adresohen dhe të kenë karakter multi-sektorial, dhe si të tilla kërkojnë një përgjigje konsistente dhe të integruar.

Problemet lokale shpesh janë të lidhura me tensione, konflikte ose ndarje në komunitetet lokale, veçanërisht përgjatë vijave etnike apo fetare. Kjo mund të bëjë mjaft të rrezikshme politikat dhe programet që përqendrohen në identitet dhe përkatësi të grupit. Kjo qasje theks që përgjigjet gjithëpërfshirëse multi-sektoriale për sfidat e përfshirjes së një zone të përcaktuar gjeografike, shpesh me një theks të fortë bujqësor. Përfshirja e bazuar nëpër zona shpesh zëvendëson theksin e zhvillimit rural me parandalim të krizave apo tema të rimëkëmbjes pas konfliktit. Sidoqoftë ajo përmban përqendrimin zhvillimor multi-sektorial dhe gjeografik (kundrejt asaj tematike). Mbështetja dhe përfshirja aktive e komuniteteve lokale janë parë shpesh si një parakusht për sukses dhe rezultat të dukshëm të projekteve të bazuar nëpër zona.

Në përgjithësi, pabarazia rurale urbane si dhe rajonale në Kosovë është e ulët, mirëpo tregon shenja të rritjes, veçanërisht në viset rurale. Siç pritej, pabarazia urbane është më e lartë se ajo e vërejtur në viset rurale. Në viset rurale, dërgesat nga jashtë duket se ngasin rritjen e pabarazisë, pasi që familjet që qëndrojnë më mirë është vërejtur se pranojnë konsiderueshëm më shumë dërgesa nga jashtë.

Migrimi mbetet një nga mekanizmat më efektiv për zvogëlimin e varfërisë në Kosovë. Për më tepër, për dallim nga rritja, ndikimi është i menjëhershëm. Për sa kohë që të vazhdojë migrimi, Kosova mund të mbështetet në dërgesat nga jashtë që mbrojnë një pjesë të madhe të

popullsisë nga varfëria. Por është e qartë se strategjia zhvillimore që mbështet shumë në dërgesat – remitancat nga jashtë nuk është as e dëshirueshme as e qëndrueshme. Arsyet janë të shumta, por tri janë me vlerë për tu përmendur. Njëra është se emigrantët ndryshojnë. Me kalimin e kohës, pasi që emigrantët të vendosen në vendet pritëse, lidhjet me “vendlindjen” e tyre kanë tendencë të rënies. Ky përkeqësim në “lidhje” pëershpejtohet me shpejtësi te gjeneratat pasuese.

Arsye tjetër është se politikat e vendit pritës ndryshojnë. Kjo është veçanërisht prekëse për Kosovën, pasi që një numër i vendeve të Bashkimit Evropian që kanë qenë pranuesit më të mëdhenj të emigrantëve nga Kosova, i kanë mbyllur kufijtë e tyre ose kanë kërcënuar se do të bëjnë një gjë të tillë. Arsyja e fundit është se dërgesat nga jashtë, të cilat në thelb janë transfere private, nuk mund të janë zëvendësuese efektive për burimet e financimit që gjenerohen brenda vendit të cilat financojnë investimet publike në infrastrukturë, kapital njerëzor, shërbime sociale e kështu me radhë. Kjo do të thotë se ekziston nevoja për tranzicion nga varësia e lartë nga migrimi dhe dërgesat nga jashtë.

Aktualisht, rreth 1 në 5 kosovarë raportojnë se kanë të paktën një anëtar të familjes që është emigrant në shtet tjetër. Në krahasim, vetëm 13 për qind e popullsisë merr përfitime nga asistensa sociale, e cila vë në shënjestër grupet më të varfra. Pjesa e popullatës që ka familjarë jashtë vendit gjithashtu raportojnë nivele më të larta të konsumit dhe vlerësohet të janë më pak të varfër. Marrë së bashku, këto konstatime sugjerojnë se pa migrim, incidenca e varfërisë do të ishte më e lartë dhe më e përqendruar në viset rurale. Prandaj çdo përpjekje që çon në reduktime drastike në modelet aktuale të migrimit ka potencial që të përkeqësojë mirëqenien e popullatës së Kosovës, që të zgjerojë pabarazitë rurale-urbane tanimë aktuale në mirëqenie, dhe me mundësi që të çojë në paqëndrueshmëri, veçanërisht në viset rurale.

Shkalla e varfërisë në viset rurale është më e lartë se në ato urbane. Për më tepër, familjet rurale kanë qasje shumëfish më të ulët në furnizim me ujë të pijshëm nga ujësjellësi, sanitacion adekuat e ngrohje qendrore në krahasim me familjet urbane. Në zonat urbane, 88.3% të amvisërive janë të lidhura me sistemin e ujësjellësit, ndërsa në zonat rurale vetëm 59.1%<sup>35</sup>. Gjithashtu, dihet se cilësia e ujit, cilësia e shërbimeve shëndetësore dhe cilësia e jetës,

<sup>35</sup> Vlerësimi i Varfërisë 2007, Banka Botërore

respektivisht, janë më të ulëta në viset rurale.

Në fakt dëshmia nga lëvizja e migrimit brenda vendit tregon se të varfrit janë duke lëvizur nga viset rurale në ato urbane për të ndjekur mundësi më të mëdha e jetë më të mirë. Viset urbane janë duke kaluar pak më mirë, pavarësisht se shuma e dërgesave nga jashtë është më e madhe për në viset rurale. Përveç largimit të nevojës për migrimin ndërkombëtar, rinnovimi urban do të merr kohë të gjatë deri në zgjidhjen e disa problemeve të vështira në zhvillimin rural. Në veçanti, rrjedhat më të mëdha të migrimit rural-urban mund të zvogëlojnë fragmentimin e mëtejmë të tokës, do të përmirësojnë produktivitetin bujqësor dhe do të përmirësojnë mirëqenien rurale.

## **Dimensioni Mjedisor**

Gjendja e mjedisit lidhet ngushtë me varfërinë dhe të drejtat themelore të njeriut. Çdo ndikim negativ në mjedisin shkakton dëmë të drejtpërdrejta në jetën e njeriut. Ajri i papastër, mungesa e ujit të pijshëm, dhe degradimi i ekosistemit dëmtojnë seriozisht shëndetin e popullatës. Shumë sëmundje kronike, ndër to edhe sëmundja e kancerit i cila është rritur dukshëm në dekadën e fundit, mund të rezultojnë nga këto zhvillime negative. Ngrohja globale ndikon direkt në ndryshimin e kushteve atmosferike të cilat mund të rezultojnë me probleme në të mbjellurat dhe të korruat në zonat rurale. Problemet mjedisore shkaktojnë vështirësi për grupe dhe qytetarët të shumtë, e posaqërshtit ata të cilët janë të varfër. Të varfërit nuk kanë mundësi të mbrohen nga efektet e ajrit të papastër, të mbulojnë shpenzimet mjekësore, të qasen në sistemin e ujërave të pijshëm apo të ri-fillojnë të mbjellurat nëpër arat e tyre që shërbejnë si mjet i vetëm i të ardhurave. Sfida të tilla rrezikojnë mirëqenien e tyre, e cila është edhe e drejtë themelore e çdo individi.

## **Aneksi 1**

### **Teksti i Rezolutës së Deklaratës së Mijëvjeçarit së Republikës së Kosovës**

Duke ndërtuar shtetin e ri, sovran dhe duke forcuar demokracinë funksionale;

Duke riafirmuar dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për respektimin e parimeve dhe vlerave të marrëveshjeve ndërkombëtare; Duke vlerësuar përpjekjet e Kombeve të Bashkuara për një botë më të mirë, më të drejtë, më prosperuese e paqësore dhe me qëllim që aktivisht t'i

kontribuojë këtyre përpjekjeve;

Duke besuar që adoptimi i Deklaratës së Mijëvjeçarit, nga e cila rrjedhin Objektivat për Zhvillim të Mijëvjeçarit, do të kontribuojë më tej në proceset e zhvillimit të Kosovës;

Duke pasur parasysh që Agjenda e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara është në përputhje me proceset e Integrimit Evropian dhe duke rikonfirmuar edhe aspiratën e Kosovës për Integrim Evropian;

Me bindje që arritja e Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit do të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar;

I vetëdijshëm që përmirësimi i mirëqenies së gjithë qytetarëve të Kosovës, nëpërmjet arritjes së Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit, do të ndihmojë vendin që të forcohet si burim i stabilitetit të brendshëm dhe atij në rajon;

Në fryshtë e parimeve e vlerave të Kombeve të Bashkuara dhe me përpjekje të shtuara për të arritur Objektivat për Zhvillim të Mijëvjeçarit,

#### Kuvendi i Republikës së Kosovës

1.Aprovon Deklaratën e Mijëvjeçarit, sipas tekstit të Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, A/RES/55/2, të datës 8 shtator 2000;

2.I kërkon Qeverisë së Republikës së Kosovës që të krijojë partneritete globale, si dhe mirëpret përkrahjen ndërkombëtare drejt arritjes së Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit në Kosovë;

3.Inkurajon autoritetet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës, shoqërinë civile, sektorin privat dhe organizatat ndërkombëtare që të përfshihen në procesin e arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, si dhe të monitorojnë e vlerësojnë përparimin deri më 2015;

4.Përkushtohet që të miratojë kornizën e nevojshme ligjore dhe të krijojë politika të duhura që mundësojnë arritjen e Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit, nëpërmjet strategjisë kombëtare për zhvillim;

5.Siguron mekanizma dhe kapacitete të duhura institucionale, si



dhe burime financiare të cilat lehtësojnë arritjen e Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit;

6.Mban seancë vjetore për të diskutuar përparimin e arritur në lidhje me Objektivat për Zhvillim të Mijëvjeçarit, bazuar në raportin e Qeverisë.

## Aneksi 2

### **Teksti i Rezolutës për Prioritete dhe Strategjité e Kosovës për Integrinë Bashkimin Evropian**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Rregullës 31 të Rregullores së Punës së Kuvendi, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 26 shkurt 2009, me propozimin e Komisionit për Integrime Evropiane, miratoi këtë

**REZOLUTË PËR PRIORITETET DHE STRATEGJITË E KOSOVËS PËR INTEGRIM NË BASHKIMIN EVROPIAN**

Duke marrë parasysh qëllimin strategjik dhe pajtimin e plotë të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian,

Me synim ndërtimin e shtetit të bazuar në sundimin e ligjit, me ekonomi të qëndrueshme dhe demokraci funksionale të mundësive të barabarta për të gjithë, në pajtim me vlerat dhe parimet e familjes Evropiane,

Duke shprehur gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për të përmbushur standardet evropiane si kushte për anëtarësim në Bashkimin Evropian,

Duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm të institucioneve të Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian dhe praninë ndërkontaktore në Kosovë dhe duke u zotuar për bashkëpunim më të ngushtë në të ardhmen,

Duke vlerësuar bashkëpunimin ndërparlamentar mes Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian dhe duke u zotuar për bashkëpunim më të ngushtë,

Duke marrë parasysh arritjet e deritashme në Procesin e Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim Asociimit të iniciuara në vitin 2004 dhe të vetëdijshëm mbi sfidat që na presin për arritjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian,

Duke qenë të vetëdijshëm se kriteret e përcaktuara nga ana e Këshillit Evropian në Kopenhangë më 1993 dhe në Madrid më 1995 janë esenciale për anëtarësim në Bashkimin Evropian,

Duke marrë parasysh se vlerësimet e dala nga Raportit i Progresit të Kosovës për vitin 2008 i përgatitur nga Komisioni Evropian, marrë në përgjithësi, janë reale, si dhe nevojën për të trajtuar sfidat e përcaktuara në këtë Raport,

Duke vlerësuar se qëllim parësor i Republikës së Kosovës për vitin 2009

është avancimi i proceseve të integrimeve evropiane me theks të veçantë arritjen e vlerësimeve pozitive të Raportit të fizibilitetit nga ana e Komisionit Evropian,

Duke u thirrur në Planin e Veprimit për Partneritet Evropian të Kosovës, përfundimet e Seancës Plenare të 11 dhjetorit 2008 dhe orientimin afatgjatë të institucioneve të Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian,

### Kuvendi i Republikës së Kosovë

1.Rikonfirmon zotimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për përmbushjen e standardeve të kërkua të integrimi në Bashkimin Evropian;

2.Zotohet se do të intensifikojë përpjekjet në përmbushjen e kërkesave të procesit të Stabilizim Asociimit të cilat shpien në nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit;

3.Vazhdon zotimet për garantimin e zbatimit të plotë të parimeve të sundimit të ligjit, ekzistimin e institucioneve demokratike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, të ekonomisë konkuruese të tregut, të kapacitetit për t'u përballur me presionet konkuruese dhe të forcave të tregut brenda Bashkimit Evropian, të zbatimit të parimeve kryesore të *acquis communautaire*, si dhe të bashkëpunimit me shtetet tjera të rajonit, siç është përcaktuar nga Kriteret e Kopenhagës më 1993 dhe të Madridit më 1995;

4.Rikonfirmon gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për thellimin e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian dhe praninë ndërkombëtare në Kosovë, me synim të fuqizimit të pozitës së Kosovës në proceset e integrimit evropian;

5.Kërkon nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që të koordinojnë përpjekjet e tyre drejt përmbushjes së rekomandimeve të përcaktuara në “Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2008, shoqëruar me Komunikatën e Komisionit Evropian drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës mbi “Strategjinë e gjerimit dhe Sfidat Kryesor 20008-2009”, si dokument kryesor për

## Integrimin Evropian të Kosovës;

6.Konsideron se ndër prioritetet kryesore për vitin 2009 i të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës është fuqizimi i dimensionit evropian në Kosovë, që do të ndikojë në arritjen e vlerësimit pozitiv nga Komisioni Evropian në Raportin e fizibilitetit;

7.Shpreh gatishmërinë për bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian në të gjitha nivelet;

8.Mbetet i përcaktuar në arritjen e sundimit të ligjit përmes reformave të sistemit të gjyqësisë, plotësimit të kornizës institucionale dhe zbatimit të të gjitha ligeve bazuar në parimin 'askush nuk është mbi ligjin';

9.Konstaton rëndësinë e jashtëzakonshme të stabilitetit në Kosovë dhe kërkon nga Qeveria Republikës së Kosovës që të shtrijë autoritetin e saj në tërë territorin me synim të integrimit të të gjitha komuniteteve në shoqërinë e Kosovës;

10.Thekson se zhvillimi ekonomik është prioritet kyç dhe shpreh përkrahjen e plotë për të gjithë aktorët ekonomikë, publikë dhe privatë, tërheqjen e investimeve të drejtpërdrejta të huaja, që do të rezultojnë me krijimin e mundësive të punësimit dhe përmbylljen transparente të procesit të privatizimit;

11.Kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që t'i intensifikojë përpjekjet e saj në reformimin e administratës publike bazuar në parimin e një administratë publike bashkëkohore dhe efektive pa ndërhyrje politike;

12.Kërkon nga institucionet e Republikës së Kosovës që të ndërmarrin veprime vendimtare për luftimin e fenomeneve negative në mënyrë që të përbushen kërkesat e Kapitullit të Drejtësisë, të Lirisë dhe të Sigurisë të Raportit të Progresit për vitin

- 2008 për Kosovën, duke përfshirë korruptionin, krimin e organizuar dhe evazionin fiskal;
13. Angazhohet për strategji të përbashkëta me Qeverinë e Republikës së Kosovës për realizimin e Standardeve Evropiane të Tregut të Brendshëm, siç përcaktohet në Raportin e Progresit për vitin 2008 për Kosovën, duke përfshirë konkurrencën, edukimin dhe hulumtimin, prokurimin publik, doganat dhe tatimet;
14. Angazhohet për strategji të përbashkëta me Qeverinë e Republikës së Kosovës për realizimin e Standardeve Evropiane të Politikave Sektoriale, siç përcaktohet në Raportin e Progresit 2008 për Kosovën, siç janë politika për energji, mjedis, industri dhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme, transport, informim dhe media, statistika, kontroll financiar, bujqësi dhe peshkatari;
15. Kërkon nga Komisioni Parlamentar për Integrime Evropiane përbushjen e detyrave dhe të obligimeve të dala nga përfundimet e Seancës Plenare të 11 dhjetorit 2008 për analizimin, planifikimin, raportimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Veprimit të Kuvendit për sfidat e Raportit të Progresit 2008 për Kosovën. Po ashtu, fton të gjitha komisionet parlamentare që të angazhohen tërësisht në realizimin e Plantit të Veprimit;
16. Angazhohet për një strategji koherente dhe harmonizim të agjendës legislative përmes bashkërendimit ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës, në veçanti duke marrë parasysh sfidat e dala nga Raporti i Progresit 2008.
17. Fton Qeverinë e Republikës së Kosovës që rregullisht dhe në mënyrë përbajtjesore të njoftojë Kuvendin e Republikës së Kosovës për progresin e arritur dhe komunikimin me institucionet e Bashkimit Evropian;
18. Përkushtohet për mbikëqyrjen e procesit të zbatimit të obligimeve të sipërpërmendura nga institucionet e Republikës së Kosovës. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës

## 1. Indikatorët e Laeken-it

Nr.	Indikatori
1	Shkalla e varfërisë relative
1.a	Shkalla e varfërisë relative <i>sipas llojit te familjes</i>
1.b	Shkalla e varfërisë relative sipas intensitetit të punës së familjes
1.c	Shkalla e varfërisë relative <i>sipas llojit te aktivitetit</i>
1.d	Shkalla e varfërisë relative sipas statusit të banimit
2	Linja e varfërisë relative (në vlera të ilustruara)
3	Raporti i kuintileve mbi të ardhurat
4	Niveli përsëritshëm i rrezikshmërisë nga varfëria
5	Hendeku i varfërisë relative
6	Kohezioni regional
7	Shkalla e papunësisë afat-gjatë
8.a	Popullsia qe jeton ne familje te papuna : fëmijët
8.b	Popullsia qe jeton ne familje te papuna : mosha adoleshente
9	Ata qe largohen herët nga shkolla, nuk arsimohen dhe nuk trajnohen më
10	Jetë- gjatësia e shëndetshme
11	Gjendja shëndetësore e vetë-përcaktuar sipas nivelit të konsumit
12	Përqendrimi rreth linjës së varfërisë
13	Shkalla e varfërisë siç matet në kohe dhe moment
14	Shkalla e varfërisë relative <i>para transfereve sociale në kesh</i>
15	Koeficienti Gini
16	Shkalla e varfërisë në mënyrë të vazhdueshme (të ardhurat më pak se 50% i mesatares së popullsisë)
17	Shkalla e varfërisë tek të punësuarit
18	Pjesë e papunësisë afat-gjate
19	Shkalla e papunësisë me kohë shumë të gjatë
20	Persona me pak vite arsimimi

## Aneksi 4. Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit

Nr.	Objektivat
1	Zhudjja e varfërisë së skajshme dhe urisë
2	Arrijten e shkollimit fillor për të gjithë
3	Promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e femrave
4	Zvogëlimin e vdekshmërisë së foshnjave
5	Përmirësimi e shëndetit të nënave
6	Luftimi i HIV/AIDS, Turbuculozës dhe sëmundjeve tjera ngjitime
7	Sigurimin e qëndrueshmërisë së ambientit
8	Krijimi i një partneriteti global për zhvillim
9*	Objektiva për Qeverisje të Mirë

\* Gjatë përpilimit të Raportit të Dytë të OZHM-ve në Kosovë shoqëria civile dhe përfaqësues të autoriteteve Kosovare caktuan edhe objektivën e nëntë për Kosovën

## Thekse Përbyllëse

Në rr Ethanat specifike të Kosovës, përfshirja sociale paraqet një sfidë komplekse të cilës institucionet e Kosovës duhet t'i qasen me sensin e urgjencës, duke shfrytëzuar kapacitetet politike, ligjore, financiare në dispozicion, si dhe duke kërkuar përkrahjen e komunitetit dhe organizatave ndërkombëtare për këtë qëllim.

Kuvendi individualisht si dhe në bashkëpunim me ekzekutivin dhe institucione tjera të qeverisjes qendrore apo lokale do të angazhohet në planifikimin e hapave më specifik, të cilët adresojnë përmirësimin e gjendjes sociale me theks përfshirjen sociale, duke ju kundërvyer kështu përjashtimit dhe cenueshmërisë sociale.

Në adresimin e sfidave të zhvillimit njerëzor dhe përfshirjes sociale në kontekst të zhvillimeve dhe praktikave të mira që marrin formë në rajon dhe vende të Bashkimit Evropian, Kuvendi i Kosovës, shpreh interesimin për të përfituar nga ndihma që ofrojnë organizatat ndërkombëtare dhe vendore, më konkretisht ndihmën përmes së cilës ne, si institucionet dhe si shoqëri më lehtësish, mund t'i qasemi në thellësi fushave të përmendura në Letrën e Bardhë. Në këtë kontekst, në kombinim me përvojat dhe shembujt e mirë rajonal dhe evropian, Kuvendi i Kosovës inkurajon dhe mirëpret ndërmarrjen e iniciativave me karakter hulumtues e analistik, asistencës teknike dhe këshillëdhënies, në mënyrë që agjenda evropiane për përfshirje sociale në vazhdimësi të ushqehet më të dhëna reale të fundit në lidhje me gjendjen e individëve dhe grupeve të përjashtuara. Në këtë mënyrë mund të evidentojmë dhe adresojmë këtë gjendje. Përkrahja nëpërmes iniciativave në fjalë do të lehtësonë proceset e inicimit dhe zhvillimit të politikave, strategjive dhe planifikimit të aktiviteteve, përfshirë edhe pasurimin e monitorimit të progresit në lidhje me përfshirjen sociale dhe përbushjen e Objektivave të Mijëvjeçarit.

Në realizimin e synimeve që lidhen me përfshirjen sociale Kuvendi i Kosovës do të angazhohet edhe në promovimin e bashkëpunimit institucional ndërkombëtar mes Kosovës, vendeve në rajon dhe më gjérë.

Letra e bardhë përbën një gurthemel në të cilin pritet të marrin formë zhvillime tjera lidhur me përfshirjen sociale. Kuvendi i Kosovës në veçanti do të angazhohet dhe përkrah procese specifike të cilat synojnë përmirësimin konkret të gjendjes në terren. Kuvendi do të përcjelle me interesim zhvillimin e këtyre proceseve si pjese e një qasjeje gjithëpërfshirëse të Kosovës, konform përkushtimit, synimit dhe përbajtjes së Letrës së bardhë dhe veçanërisht Deklaratës së Mijëvjeçarit.

